

## **HYRJE**

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 42 të Rregullores për vetëqeverisjen e komunave në Kosovë, nr. 2000/45, në dispozitat e nenit 40, shkronja (ç) të Statutit të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, kryeshefi i Ekzekutivit, përmes Bordit të drejtorëve, i dërgon Kuvendit të Komunës për miratim raportin e punës për vitin 2005. Raporti i punës nga Kuvendi duhet të miratohet më së voni deri më 30 maj të vitit vijues.

## **PËRGJEGJËSITË E KRYESHEFIT TË EKZEKUTIVIT DHE TË BORDIT TË DREJTORËVE**

Kryeshefi i Ekzekutivit dhe Bordi i drejtorëve ushtrojnë pushtetin ekzekutiv dhe zbatojnë rregullat e miratuara nga Kuvendi i Komunës dhe ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës, të cilat janë të fuqizuara me nënshkrimin e tyre nga ana e përfaqësuesit special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, brenda fushës së përgjegjësisë së Komunës.

Në periudhën për të cilën po raportohet, Shërbimin civil e përbëjnë: kryeshefi i Ekzekutivit, zëv.kryeshefi, 13 drejtori, Zyra e komuniteteve në Graçanicë, zyrtarë të lidhur drejtpërdrejt (me të drejtë dhe përgjegjësi) me Zyrën e kryeshefit të Ekzekutivit : zyrtari për çështje gjinore dhe mundësi të barabarta, zyrtari për kthim, revizori i brendshëm financiar, si dhe Zyra ligjore, Zyra për marrëdhënie me publikun, Zyra pritëse dhe Departamenti i Prokurimit, të cilat janë të renditura në njësinë monitoruese. Organizimi i tillë është miratuar në seancën e mbledhjes së mbajtur më 31.01.2005.

Po ashtu, kryeshefi i Ekzekutivit, me ndihmën e Bordit të drejtorëve, ka siguruar që edhe institucionet (arsimore dhe shëndetësore) dhe ndërmarrjet, të qeverisen dhe të koordinohen në mënyrë efikase në të gjitha fushat.

## **GJENDJA**

Gjatë vitit 2005, puna e kryeshefit të Ekzekutivit, së bashku me Bordin e drejtorëve, ka qenë e orientuar në:

- harmonizimin e rregulloreve komunale me ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës, si dhe nxjerrjen e tyre në pajtim me obligimet ligjore që kanë rrjedhur për Komunë,
- rritjen e realizimit të të hyrave vetanake për 31%, nga viti 2004 = 3.776.173.75, në 4.947.127,17 në vitin 2005,
- ngritjen e nivelit në punë, që është arritur në bazë të përvojave të fituara nga trajnimet në vitin paraprak dhe gjatë kohës së raportimit, aplikimit të internetit dhe të intranetit, furnizimit me pajisje kompjuterike etj.,
- avancimin e të dhënave në “web-faqen” e Komunës dhe në vitin vijues ajo do të publikohet edhe në gjuhët zyrtare. Në të ardhmen pritet që Komuna të ketë edhe buletin (gazetën) e saj, i cili në fillim do të dilte një herë në muaj,
- ngritjen e cilësisë së shërbimeve publike, si në qytet ashtu edhe në rajonet rurale,

- miratimin e planeve, ku në vitin paraprak i kishim të miratuara tri plane rregulluese, e në vitin raportues kemi të miratuara edhe pesë plane rregulluese, të gjitha këto për pjeset urbane.

- realizimin e projekteve në lëmin e kulturës, gjinisë, rinisë dhe të sportit,

- zbatimin e rregullativave ligjore, brenda mundësive që kishim, me anën e të cilave ndërmarrjet të cilat janë në kompetencë të Komunës të kenë mbarëvajtje në punë në fushat që janë në kompetencë të tyre, etj.

## **DETYRAT**

Në vitin vijues prioritet do t'u jepet:

- çështjes së ndërtimeve ilegale,
- lirim të pronës komunale,
- ngritjes së nivelit të realizimit të të hyrave vetanake,
- kompletimit të planeve rregulluese,
- përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësive që kanë të bëjnë me realizimin e standardeve për Kosovën, për Komunën e Prishtinës,
- sigurimit të donacioneve për realizimin e projekteve kapitale etj.

Të gjitha të arriturat e kryeshefit të Ekzekutivit dhe të Bordit të drejtorëve, janë bërë me një përkushtim dhe bashkëpunim të ngushtë me nëpunësit e shërbimit civil, institucionet që qeverisen nga Komuna, drejtorë të drejtorive, Avokaturën Publike, trupat e Kuvendit (komitetet), pjesën udhëheqëse politike të Komunës, ministritë si IPVQ, përfaqësuesit e UNMIK-ut, të KFOR-it, të SHPK-së, të AKM-së etj..

Me që jemi në prag të zgjidhjes së statusit të Kosovës, kryeshefi i Ekzekutivit, së bashku me Bordin e drejtorëve dhe pjesën politike, kanë përmbushur proceset lidhur me përmbushjen e standardeve, për çka flasim edhe rezultatet e arritura.

## **I . INSTITUCIONET DEMOKRATIKE KOMUNALE**

Institucionet demokratike komunale, ku janë të përfshira të gjitha komunitetet që jetojnë dhe veprojnë në territorin e komunës së Prishtinës, janë të përfaqësuara në mënyrë proporcionale në Kuvend dhe në trupat ndihmëse të Kuvendit - në komitete, me përjashtim të Komitetit për komunitete dhe të Komitetit për ndërmjetësim, ku komuniteti serb nuk merr pjesë, edhe përkundër përpjekjeve të udhëheqjes komunale për t'i bindur që të marrin pjesë dhe të kontribuojnë bashkërisht me komunitetet tjera.

\* ***Gjuhët zyrtare respektohen në të gjitha organet dhe institucionet e Komunës, gjë që vërtetohet nga të dhënat e mëposhtme:***

- *palës i kthehet përgjigjja në gjuhën në të cilën e parashtron kërkesën,*
- *përkthimet bëhen në gjuhët zyrtare,*
- *mbishkrimet e vendosura nga institucionet komunale, përfshirë këtu ARSIMIN, SHËNDETËSINË, emërtimet e rrugëve, të qyteteve dhe të fshatrave janë të shkruara në gjuhët zyrtare.*

- Shërbimi civil profesional është i paanshëm dhe i përgjegjshëm, i përfaqësuar nga të gjitha komunitetet në Komunën e Prishtinës, përfshirë këtu numër të theksuar të gjinisë femërore përafërsisht 30 % .
- Të gjitha komunitetet kanë qasje të drejtë në punësim në institucionet publike.
- Ekzistojnë kodet e mirësjelljes dhe procedurat e zbatimit, të cilat sigurojnë qeverisje transparente dhe të përgjegjshme ndaj rekomandimeve që vijnë nga niveli qendror.
- Propozimvendimet dhe rregulloret e Kuvendit të Komunës shqyrtohen nga komitetet përkatëse para se të miratohen nga Kuvendi.
- Është bërë përpjekje për zhbërjen e strukturave paralele, duke i siguruar sidomos komunitetit serb shërbimet e nevojshme, si në administratë, arsim, shëndetësi, transport etj.
- Të gjitha format e nxitjes së urrejtjes (në rast se paraqiten), dënohen nga udhëheqësit politikë në të gjitha format e mundshme brenda kompetencave tona, duke përfshirë këtu edhe mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në tubime të ndryshme.

## **II. SUNDIMI I LIGJIT**

Ligji dhe të gjitha vendimet dhe rregulloret e miratuara nga Kuvendi i Komunës, zbatohen njësoj ndaj të gjithë qytetarëve, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, fetare, gjinore etj..

## **III. LIRIA E LËVIZJES**

Të gjithë qytetarët e komunën së Prishtinës janë të lirë të udhëtojnë, të punojnë dhe të jetojnë të sigurt, të pafrikësuar prej ndonjë sulmi apo keqtrajtimi, pavarësisht nga përkatësia etnike e tyre.

Të gjithë qytetarët janë të lirë të përdorin gjuhët e tyre, përfshirë këtu vendet publike, dhe është e sigurt liria e lëvizjes së tyre. Ata shkojnë pa pengesë në vendet e tyre të punës, në tregje, kryejnë shërbimet publike, sociale dhe shërbimet komunale.

Në komunën e Prishtinës përcjellja policore e pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë më nuk është e nevojshme, nga se e kanë të siguruar transportin publik.

Punonjësit publikë, pjesëtarë të komuniteteve joshumicë, të punësuar në organet e Komunës së Prishtinës, janë në gjendje të punojnë bashkë me pjesëtarët e komunitetit shumicë pa ndonjë vështirësi.

Numri i incidenteve, që kanë të bëjnë me lirinë e lëvizjes së pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë në komunën e Prishtinës, viteve të fundit është shumë i rrallë apo nuk ekziston fare.

Udhëheqësit komunalë pa hezitim do t'i dënojnë aktet eventuale të dhunës ndaj pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë.

Komuna ka siguruar shërbime përkatëse të përkthimit për të gjitha bashkësitë, duke përfshirë përkthimin e të gjitha dokumenteve zyrtare, si dhe përkthimin simultan në gjuhët përkatëse gjatë mbledhjeve zyrtare. Kjo bëhet nga Shërbimi i përkthimeve, të cilin e ka formuar Komuna.

## **IV. KTHIMI I QËNDRUESHËM DHE TË DREJTAT E BASHKËSIVE DHE TË PJESËTARËVE TË TYRE**

Të gjithë refugjatët dhe të zhvendosurit, të cilët dëshirojnë të kthehen në pronat e tyre në territorin e komunës së Prishtinës, do të jenë të papenguar për t'u kthyer, dhe këtë mund ta bëjnë pa problem.

Në Komunë ekzistojnë mekanizma përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve, si Zyra komunale për komunitete në Graçanicë dhe komitetet e Kuvendit të Komunës së Prishtinës të cilat funksionojnë.

Është bërë shpërndarje e drejtë e resurseve komunale për të gjitha komunitetet.

Duhet theksuar se në vitin 2005, kryesisht në rajonet rurale, janë kthyer 11 familje serbe, me 41 anëtarë, 10 familje ashkali, me 54 anëtarë dhe 1 familje boshnjake, me 4 anëtarë.

## **V. EKONOMIA**

Autoritetet komunale përkrahin privatizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore.

Të hyrat nga tarifat mbushin buxhetin e Komunës. Treguesit tregojnë se këto të hyra janë në rritje. Arkëtimi i taksave nga Komuna është duke u bërë pa ndikim politik.

## **VI. TË DREJTAT PRONËSORE**

Zbatimi i drejtë i të drejtave pronësore është synim i përhershëm i Komunës, për të inkurajuar kthimin dhe për të siguruar trajtim të barabartë të bashkësive etnike.

Është krijuar dhe funksionon regjistri i të drejtave pronësore dhe janë kompletuar incizimet kadastrale të Komunës.

Trashëgimia kulturore e komunës respektohet si trashëgim i të gjitha bashkësive etnike, fetare dhe gjuhësore të qytetarëve të kësaj komune.

Të gjitha bashkësitë kanë të drejtë ta ruajnë dhe t'i mbrojnë vendet që janë të rëndësishme për trashëgiminë e tyre kulturore, historike dhe fetare, me ndihmën e autoriteteve komunale, në pajtim me standardet evropiane.

Në fund, duhet theksuar se Komuna vazhdimisht ka bashkëpunuar me nivelin qendror, sidomos me Ministrinë e Pushtetit Lokal, ku për çdo të arritur në plotësimin e standardeve i është raportuar kësaj ministrie.

Vlerësimet e përgjithshme janë se Komuna e Prishtinës ka arritur suksese në plotësimin e standardeve, obligim ky i përhershëm për ne.

Në vazhdim do të jepet pasqyra e punës së organeve të administratës, e zyrtarëve dhe zyrave të Njësisë monitoruese, me radhitje ashtu siç është miratuar skema organizative.

## **ZYRTARJA PËR ÇËSHTJE GJINORE DHE MUNDËSI TË BARABARTA**

Kjo zyrtare gjatë kësaj periudhe ka kryer këto pune:

- ka bërë vizita në institucionet arsimore, shëndetësore dhe OJQ-të lokale për njohjen me mundësinë e punësimit të gjinive,
- ka bërë vizita në zonat rurale për zgjidhjen e çështjeve gjinore,
- ka bërë vizitë në Slloveni, në muajin nëntor të vitit raportues, me qëllim të aftësimin për zgjidhje sa më të suksesshme të çështjeve gjinore,
- ka zhvilluar bashkëpunim me zyrat për çështje gjinore pranë komunave të Kosovës, të ministrive dhe të Zyrës së kryeministrit, si dhe me OJQ-të të cilat kanë interes për mbrojtjen e çështjeve gjinore,
- ka marrë pjesë në konferencat e organizuara me temën “Ndal trafikut ndaj qenies njerëzore” dhe “Ndal dhunës ndaj femrave”,
- ka marrë pjesë në projektet – trajnimet:

“Të drejtat ekonomike të grave”,  
“Të drejtat juridike të grave” dhe  
“Dita ndërkombëtare kundër diskriminimit të gruas”.

## **ZYRTARI PËR KTHIM**

Zyrtari për kthim gjatë kësaj periudhe:

- ka mbajtur 22 takime pune me zyrtarët rajonalë të UNMIK-ut, UNHCR-së, OSBE-së, UNDP-së, DRC-së, “Mercy Corps”-it, ICMC-së dhe të OJQ-ve të tjera të vendit dhe ndërkombëtare,
- ka bërë 12 vizita me pjesëtarët serbë, ashakli, romë etj., në pronat dhe varrezat e të zhvendosurve të komuniteteve joshumicë,
- ka marrë pjesë në takimet që janë mbajtur në Bashkësinë lokale në fshatin Bardhosh,
- ka marrë pjesë aktive në Komitetin për komunitete etj..

Kjo zyrë ka funksionuar me një zyrtar, edhe pse me skemën organizative ka qenë e paraparë që kjo zyrë të funksionojë me dy zyrtarë. Mungesa e paraqitjes së kandidatëve për këtë post, ka ndikuar që kjo pozitë të mbulohet në vitin vijues.

## **REVIZORI I BRENDSHËM FINANCIAR**

Gjatë vitit raportues, revizori i brendshëm financiar ka zhvilluar këto aktivitete:

- ka udhëhequr ekipin pilot të auditimit, i cili u zbatua në Komunë. Bashkë me menaxhmentin kanë vendosur që temat e auditimit të jenë kërkesat e palëve drejtuar Drejtoratit të Administratës së Përgjithshme – Ofiqarisë dhe Sektorit të biznesit në kuder të Drejtoratit të Ekonomisë. Gjatë auditimit është konstatuar se punët janë kryer në pajtueshmëri me rregullat e Komunës dhe ligjet aplikative,
- ka bërë auditim në ndërmarrjen komunale publike “Trafiku Urban” me seli në Prishtinë, dhe ka konstatuar se janë duke u aplikuar procedurat buxhetore shpenzuese dhe të hyrat përbrenda ndërmarrjes. Për konstatimin e auditimit të bërë, revizori ka njoftuar kryeshefin e Ekzekutivit,
- ka marrë pjesë në takimet me ekspertët e kontrollit të brendshëm, të organizuar nga Ministria e Financave e Sllovenisë, nga 14 - 21 dhjetor 2005.

## **ZYRA LIGJORE**

Gjatë kësaj periudhe Zyra ligjore:

- ka ofruar udhëheqje juridike, shërbime, këshillime dhe ekspertizë për Kuvendin e Komunës, Ekzekutivin, drejtoritë dhe sektorët,
- ka shqyrtuar të gjitha projektpropozimet të cilat janë dërguar nga drejtoritë për miratim nga Kuvendi, duke garantuar pajtueshmëri të plotë me ligjet në fuqi,
- ka shqyrtuar ankesat e drejtuara kryeshefit të Ekzekutivit nga ana e personave fizikë dhe juridikë gjithsejt 102, nga të cilat 4 janë aprovuar, 87 janë refuzuar, 11 ankesa janë bartur në vitin vijues,

- ka përpiluar urdhëresat administrative që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e punëve në organeve e administratës,
- përmes përfaqësuesit të saj, ka marrë pjesë aktive në Grupin për standarde në Komunë, në ministri etj.

Zyra ligjore, gjatë vitit raportues, gjithë këtë aktivitet e ka zhvilluar me tre të punësuar.

## **ZYRA PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN**

Kjo zyrë brenda periudhës raportuese, me një angazhim të përhershëm:

- ka siguruar qasje publike dhe transparencë për punën e Kuvendit, të trupave të Kuvendit dhe të Bordit të drejtorëve, duke u ofruar informata dhe dokumente opinionit publik dhe mediave,
- ka informuar publikun për vendimet e marra nga ana e Kuvendit të Komunës, me anë të lëshimit të kumtesave për shtyp,
- është kujdesur që pozicionet e Komunës të shpallen publikisht në fushat e informimit publik, me kërkesa të shtypit dhe me paraqitjet e anëtarëve të drejtorive në media,
- ka mbajtur lidhje me shtypin lokal për çështjet që kanë të bëjnë me Komunën,
- ka përgatitur udhërrëfyesin me titull “Prishtina”, i cili u botua në fillim të vitit vijues,
- është angazhuar për një dizainim të ri të “Web-faqes”, në të tri gjuhët: shqip, anglisht dhe serbisht,
- ka bashkëpunuar me të punësuarit në Shërbimin civil, e sidomos me drejtorët e drejtorive.

Zyra ka funksionuar me tre punëtorë.

## **DEPARTAMENTI I PROKURIMIT**

Gjatë kësaj periudhe ky departament ka realizuar 234 projekte të kontraktuara, të cilat projekte janë mbikëqyrë nga komisionet profesionale.

Puna e arritur është meritë e shtatë të punësuarve, prej të cilëve tre zyrtarë dhe menaxheri i Departamentit të Prokurimit që kanë qenë të kyçur drejtpërdrejtë në departament, njëherësh, të njëjtit kanë qenë të certifikuara për vitin 2005.

Vlera e projektit për ndërtimin e kompleksit të banesave në lagjen “Kodra e Diellit” në Prishtinë nuk është dhënë në vlerë, nga se përfitimi bazë është në vlerën dhe sasinë e objekteve që i përfiton Komuna.

Tenderi për ndërtimin e garazheve publike i ka kaluar procedurat tjera ligjore, aprovimi i tij do të bëhet pas miratimit nga Zyra ligjore e UNMIK-ut.

Bazuar në raportin mes punëve (së bashku me projektet dhe shërbimet e obligueshme) dhe mallrave (pa llogaritur këtu mallrat për shkolla), mund të vijmë te konstatimi se mbi 80 % të mjeteve buxhetore janë shpenzuar për investime kapitale apo të kësaj natyre.

**Vërejtje:** Në raport nuk është paraqitur puna e Avokaturës publike, ngase ajo, në pajtim me Ligjin për avokaturën publike dhe ndihmën juridike, i cili është ligj aplikativ, i përgjigjet drejtpërsëdrejti Kuvendit dhe duhet raport i veçantë.

# I. DREJTORATI I ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

## 1. Sektori i punëve të përgjithshme dhe juridike

### a) PERSONELI

Krahasuar me vitin 2004, kur administrata komunale ka pasur 646 të punësuar, në vitin raportues administrata ka pasur 620 të punësuar.

Zvogëlimi i numrit të punëtorëve , krahasuar me vitin paraprak, është bërë nga arsyet se:

- 12 punëtorëve iu është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të plotësimit të kushteve për pensionim (mosha 65-vjeçare),
- 4 punëtorë të larguar nga Shërbimi civil i administratës për shkak të shkeljeve të kodit të mirësjelljes,
- 3 punëtorë kanë ndërruar jetë,
- 7 punëtorë, marëdhënien e punës e kanë ndërprer me vetëdëshirë.

Pranimi i punëtorëve të rinj nuk është bërë për shkak të ndalesës e cila është bërë nga niveli qendror.

Personeli ka kryer punën e vet në bazë të dispozitave të cilat përcaktojnë fushëveprimin e personelit, mbështetur në Rregulloren nr. 2001/36, Urdhëresën administrative, nr. 2003/02, për implementimin e Rregullores nr. 2001/36.

Edhe përkundër nënshkrimit të Kontratës kolektive dhe Anekskontratës, nga ana e tri palëve: Qeverisë, Odës Ekonomike dhe Sindikatës, kemi moszbatimin e saj, e cila ka ndikuar që të ketë vështirësi dhe pakënaqësi të punësuarit në Shërbimin civil, sa i përket realizimit të të drejtave në pushim të lehonisë, pushim mjekësor etj. Arsyet e moszbatimit të dispozitave të Kontratës kolektive është mungesa e fondeve për qëllimet e cekura.

## REGJISTRI I PUNËTORËVE ME NUMRIN E PËRGJITHSHËM , KUALIFIKIMET, STRUKTURËN ETNIKE DHE STRUKTURËN GJINORE, SIPAS DREJTORIVE

Nr. Ren	DREJTORATET	Nr. i përgj.	Kualifikimet				Struktura etnike				Struktura gjinore	
			Fak.	Shk e lartë	Shk. e mesme	Stafi mbësht.	Shqiptar	Serb	Turq	Te tjere	M	F
1.	Drejtoria i Administratës	154	15	8	107	24	145	3	5	1	111	43
2.	Drejtoria i Inspektionit	64	29	3	32	-	63	-	-	1	46	18
3.	Drejtoria i Fin. Dhe i Pronës	53	10	7	35	1	52	-	1	-	34	19
4.	Drejtoria i Urbanizmit	30	17	2	10	1	27	1	1	1	13	17
5.	Drejtoria i Shërb.Publike	31	10	4	17	-	31	-	-	-	21	10
6.	Drejtoria i Shëndetësisë	13	8	-	5	-	13	-	-	-	7	6
7.	Drejtoria i Kad. Dhe i Gjeod.	29	3	2	23	1	29	-	-	-	16	13
8.	Drejtoria i Ekonomisë	15	10	-	5	-	14	-	1	-	8	7
9.	Drejtoria i Ars. Dhe i Shken.	24	21	1	2	-	22	-	1	1	12	12
10.	Drejtoria i Zhvill.Rural	8	7	-	1	-	8	-	-	-	5	3
11.	Drejtoria i Kultur. Dhe i Gjin.	5	5	-	-	-	5	-	-	-	1	4
12.	Drejtoria i Sportit dhe i Rin.	2	2	-	-	-	2	-	-	-	1	1
13.	Drejtoria i MCE-së	153	10	10	133	-	125	28	-	-	147	6
14.	Njësia Monit. Me Zyrat	34	23	-	11	-	32	2	-	-	19	15
15.	Kryesia	5	5	-	-	-	4	1	-	-	5	-
	<b>Gjithsej:</b>	<b>620</b>	<b>175</b>	<b>37</b>	<b>381</b>	<b>27</b>	<b>572</b>	<b>35</b>	<b>9</b>	<b>4</b>	<b>446</b>	<b>174</b>

**PUNËTORËT E DREJTORATIT TË KULTURËS DHE TË GJINISË NËPËR  
INSTITUCIONET JASHTË KOMUNËS**

Nr. rend.	Emri i Institucionit	Nr. i përgjith.	Fak.	Lartë	Mesme	Stafi mbështetës	Shqiptarë	Serbë	Turq	Të tjerë	M
1.	Instituti i Monumenteve dhe Muzeu Rajonal i Prishtinës	6	-	-	3	3	6	-	-	-	3
2.	Arkivi Historik i Qytetit të Prishtinës	8	-	-	8	-	8	-	-	-	4
3.	Biblioteka ndërkomunale "Hivzi Sylejmani" në Prishtinë	15	1	1	13	-	15	-	-	-	7
4.	Qendra e Pionerëve Prishtinë	6	1	-	5	-	6	-	-	-	3
5.	Teatri "Dodona" Prishtinë	19	3	-	14	2	19	-	-	-	15
6.	Shtëpia e Kulturës në Graçanicë	11	1	2	8	-	-	10	-	1	9
	<b>Gjithësej:</b>	<b>65</b>	<b>6</b>	<b>3</b>	<b>51</b>	<b>5</b>	<b>54</b>	<b>10</b>	<b>-</b>	<b>1</b>	<b>41</b>

**REGJISTRI I PUNËTORËVE NË ZYRËN E KOMUNITETEVE NË GRAÇANICË**

Nr. ren	Zyra e Komuniteteve ne Graçanicë	Nr. i përgjith.	Fak.	Lartë	mesme	Stafi mbështetës	shqiptar	serb	Turq	Te tjere	M	F
1.	Zyra e Komuniteteve	27	5	4	14	4	-	25	-	2	23	4
	<b>Gjithsej</b>	<b>27</b>	<b>5</b>	<b>4</b>	<b>14</b>	<b>4</b>	<b>-</b>	<b>25</b>	<b>-</b>	<b>2</b>	<b>23</b>	<b>4</b>

**b) BYROTEKNIKA**

Aktiviteti i përhershëm i byroteknikës ka qenë shumëzimi dhe fotokopjimi i materialeve për nevojat e zyrave – sektorëve të drejtorive, të trupave të Kuvendit, të Avokaturës publike dhe të Kuvendit.

Më poshtë jepet pasqyra tabelare, nga e cila shihet se, krahasuar me vitin 2004, kemi zvogëlim të shumëzimit të materialit, nga 614641 sa ka qenë numri i kopjeve në 408405, jo



për shkak të aktivitetit të organeve të cekura, por nga arsyeja se Drejtorati i Planifikimit, Urbanizëm dhe i Ndërtimit, ka bërë shumëzimin e materialit me mjetet e saja, aplikimi i intranetit tek shërbyesit civilë etj.

Gjithashtu, në vitin raportues është bërë ndërrimi i aparaturës, i cili ka ndikuar në kryerjen më cilësore të punëve të besuara.

Nr.rend.	KOMUNA	Nr.i kopjeve	Nr.i risave të shpenz.
1.	Drejtorati i Adm. së Përgjithshme	194499	389
2.	Drejtorati i Financave dhe i Pronës	47170	94
3.	Drejtorati i Ekonomisë	2027	
4.	Drejtorati i Planifikimit dhe i Urbanizmit	-	-
5.	Drejtorati i Kulturës dhe i Gjinisë	50	
6.	Drejtorati i Shërbimeve Publike	409	1
7.	Drejtorati i Zhvillimit Rural dhe i Bujqësisë	5555	11
8.	Drejtorati i Mbrojtjes Civile dhe i Emergjencës	1430	3
9.	Drejtorati i Shëndetësisë	27799	41
10.	Drejtorati i Arsimit dhe i Shkencës	8048	16
11.	Drejtorati i Inspektionit	15557	31
12.	Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë	500	1
13.	Zyra e prokurimit	57570	114
14.	Kuvendi i Komunës	26536	53
15.	Të tjera	15165	6
16.	Avokatura komunale	70	
	<b>Gjithsej</b>	<b>408.405</b>	<b>776</b>

## 2. Sektori për punë të Kuvendit dhe të Ekzekutivit

Në bazë të shënimeve që ka ky sektor, rezulton se :

- Kuvendi i Komunës ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta,
- Bordi i drejtorëve ka mbajtur 48 mbledhje të rregullta dhe konsultative,
- Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 10 mbledhje,
- komitetet tjera obligative dhe joobligative kanë mbajtur 312 mbledhje,
- Grupi për standarde ka mbajtur një mbledhje,
- Grupi punues komunal për kthim ka mbajtur 4 mbledhje, dhe
- janë mbajtur disa mbledhje me qytetarë.

Gjatë periudhës raportuese janë miratuar:

- 5 rregullore,
- 6 rregullore për ndryshim dhe plotësim të rregulloreve komunale,
- 71 vendime nga kompetenca dhe fushëveprimi i Kuvendit.

Krahasuar me vitin paraprak, kemi rritjen e numrit të takimeve të komiteteve të tjera, nga 236 në 312 mbledhje. Bordi i drejtorëve ka konkluduar se numëri kaq i madh i takimeve, i caktuar nga ana e këtyre komiteteve, është i panevojshëm.

### **3. Sektori teknik**

Aktiviteti i këtij sektori është mbështetur në zbatimin e përpiktë të detyrave dhe punëve të caktuara me Rregulloren për organizmin dhe sistematizimin e vendeve të punës, dhe atë:

- sigurimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të Komunës,
- mirëmbajtjen e pajisjeve në sallën e Kuvendit të Komunës,
- furnizimin e bufesë,
- mirëmbajtjen e rrjetit telefonik,
- punë që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e automjeteve për nevoja zyrtare etj..

Duhet theksuar se sigurimin e objekteve të Komunës, përveç personelit në marrëdhënie të rregullt pune, e kanë bërë edhe kompanitë private. Kjo ka ndodhur nga arsyeja e ndalimit të pranimit të punëtorëve të rinj nga ana enivelit qendror.

Sigurimi nga ana e kompanive ka qenë i domosdoshëm, ngase zyrat e drejtorieve janë të shkapërderdhura.

Në mungesë të personelit që duhej të ishte i angazhuar për vozitjen e automjeteve zyrtare, vozitja e automjeteve shpesh është bërë nga ana e vet personave zyrtarë.

### **4. Sektori i bashkësive lokale**

Gjatë periudhës raportuese nga ky sektor janë zhvilluar këto aktivitete:

- janë mbajtur 12 takime të rregullta me kryetarët e Bl-ve,
- janë mbajtur 12 takime me këshilla të bashkësive lokale,
- është bërë lëshimi i vërtetimeve dhe i shkresave tjera, që janë në kompetencë të këtij sektori,
- është zhvilluar bashkëpunimi mes drejtorive përkatëse dhe këshillave të bashkësive lokale rreth projekteve të ndryshme,
- është realizuar projekti për caktimin e lokacionit për zyrën e Bashkësisë lokale në fshatin Hajvali,
- është kryer projekti i ndërtimit të zyrave të vendit dhe të bashkësive lokale.

Problemet e natyrës së punës me palë, që kanë qenë të raportuara në vitin paraprak, kanë mbetur edhe në vitin vijues. Fjala është për atë se realizimi i të drejtave nuk është bërë në këto zyra në mungesë të vulës, por kjo është bërë në qendër. Përkundër bashkëpunimit që ka ekzistuar mes drejtoratit, ministrisë përkatëse dhe përfaqësuesve të UNMIK-ut, një gjë e tillë deri më sot nuk arriti të zgjidhet .

### **5. Sektori i gjendjes civile**

Krahasuar me periudhën e njëjtë, kërkesat e palëve për lëshimin e dokumentacionit që ka të bëjë me statusin civil të tyre, kanë shënuar rritje. Rritje ka pasur edhe te procedura administrative e zhvilluar për ndërrimet dhe korrigjimet e emrave personalë.

Në vitin raportues kishim gjithsej 1494 kërkesa, nga të cilat janë zgjidhur 1469, për vitin vijues në procedurë për zgjidhje kanë mbetur edhe 25 kërkesa.

Në vazhdim jepet pasqyra tabelare e punës së Sektorit të gjendjes civile:

Në periudhën raportuese, janar - dhjetor 2005, në Shërbimin e gjendjes civile janë kryer punët si në vijim :

- janë regjistruar në librin amzë të të lindurve LAL.....	10574
- regjistrime të mëvonshme në LAL .....	31092
- janë regjistruar në librin amzë të të martuarve LAM.....	1085
- regjistrime të mëvonshme në LAM.....	1303
- regjistrime të reja në librin amzë të të vdekurve LAV.....	2486
- regjistrime të mëvonshme në LAV.....	1030

Gjatë periudhës raportuese, lindje, martesë, vdekje që kanë të bëjnë me qytetarët tanë jashtë Kosovës, të ashtuquajturat regjistrime speciale, janë evidencuar si në vijim :

-regjistrime speciale në LAL.....	808
-regjistrime speciale në LAM.....	97
-regjistrime speciale në LAV.....	34
-certifikata të lindjes ( të lëshuara).....	3096
-certifikata të martesës.....	224
-certifikata të vdekjes.....	47

Bazuar në kërkesat e palëve, gjatë periudhës raportuese janë lëshuar :

-certifikata të lindjes.....	45702
-certifikata martesore.....	3215
-certifikata të vdekjes.....	3336
-certifikata të statusit martesor.....	3128
-vërtetime – dëshmi se personi është në jetë.....	1025
-deklarata mbi bashkësinë familjare.....	2217
-deklarata të konfirmuara nga dy dëshmitarë.....	73
-vërtetim i kopjeve të dokumenteve .....	8919

## II. DREJTORATI I EKONOMISË

Në bazë të planit të detajuar, kjo drejtori ka zhvilluar këto aktivitete:

- nxjerrja e rregulloreve nga fushëveprimi i Drejtoratit të Ekonomisë, të harmonizuara me ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës, të miratuara në vitin paraprak dhe në vitin raportues (Rregullorja për leje pune të shoqërive tregtare, Rregullorja për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës, Rregullorja për transportin e udhëtarëve me auto-taxi, Rregullorja për tarifa dhe ngarkesa etj). Ky aktivitet i lëmit të harmonizimit të akteve është bërë në bashkëpunim të plotë me Drejtoratin e Shërbimeve Publike, Transportit, Ambientit dhe të Tokës Ndërtimore, Drejtoratin e Inspeksionit, Zyrën ligjore dhe Zyrën e prokurimit,
- përpjekje të vazhdueshme nga ana e kësaj drejtorie për rritjen e numrit të aplikuesve për leje pune, përsosjen e modaliteteve për dokumentacionin e lejes për punë nga arsyea e eliminimit të keqpërdorimeve të mundshme, duke aplikuar “IT” të sofistikuara.

- bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë lidhur me nxjerrjen e urdhëresave, përkatësisht udhëzimeve administrative përkitazi me aplikimin sa më të drejtë të Ligjit për tregtinë e brendshme, Ligjit për hoteleri, Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve dhe Ligjit për zejtarë. Drejtoria, përmes personave zyrtar të saj, ka marrë pjesë edhe në projektin e ndihmës për NVM-të - sistemi "Vaucher", projekt i financuar nga BE-ja. Pjesëmarrja në juri për përzgjedhjen e 10 kompanive më të suksesshme në Kosovë për vitin 2005,

- bashkëpunimi me institutin "Riinvest" për themelimin e Asociacionit të Biznesit,

- realizimi i projektit të dytë, në bashkëpunim me KFOR-in finlandez dhe Ministrinë e Jashtme të Finlandës, me ç'rast u janë dhënë 30.000 € mjete kompanive dhe individëve që merren me prodhimtari, të cilët veprimtarinë e biznesit e zhvillojnë në komunën e Prishtinës.

- në bashkëpunim me Zyrën rajonale të punësimit dhe Zyrën regjionale për trajnime, është realizuar projekti "Trajnimi i të rinjve të papunë në ndërmarrësi". Në këtë projekt janë aftësuar 55 pjesëmarrës,

- inkasimi i 364.683.03 €, të hyra nga lëshimi i lejeve për punë në aspektin e përmbushjes së objektivave financiare.

Detyrë e kësaj drejtorie për vitin vijues mbetet që, në bashkëpunim me komunitetin e biznesit, të njëjtit të vijnë dhe të konkurrojnë për lëshimin e lejeve të punës, duke garantuar se Komuna do të bëjë caktim të arsyeshëm të tarifave për ushtrim të biznesit. Gjithashtu, detyrë e drejtorisë do të jetë që të punohet në planin zhvillimor afatmesëm në lëmin e ekonomisë, jo vetëm për nivelin e Komunës, por edhe nivelin e Kosovës.

### **III DREJTORATI I FINANCIVE DHE I PRONËS**

#### **1. Sektori i taksës në pronë**

##### **a) Operimi kompjuterik**

Gjatë viti 2005 janë kryer këto punë:

- janë nxjerrë 5141 fatura të tatimit në pronë, duke bërë edhe regjistrat e objekteve të reja,

- janë regjistruar 8146 pagesa në bazë të raporti për pagesën e tatimit,

- janë regjistruar 4251 gjoba të shqiptuara në komunikacion,

- janë nxjerrë vendime për 1555 raste me të cilat është bërë përmirësimi i zonave dhe i kategorive tatimore të tatimpaguesve,

- janë bërë ndryshime të rrugëve për tatimpaguesit në 7540 raste,

- janë regjistruar 1650 lëndë sipas aktvendimeve me ankesë,

- janë lëshuar 5145 vërtetime për kryerjen e obligimeve tatimore nga ana e tatimpaguesve.

##### **b) Mbledhje e shënimeve**

Në bazë të shënimeve vijmë në përfundim se:

- janë regjistruar 255 objekte të cilat nuk kanë qenë të regjistruara në vitin 2004,

- janë regjistruar 350 objekte të banimit: shtëpi, banesa, garazhe etj,

- është bërë kontrollimi i sërishëm i objekteve në terren në bazë të 1210 ankesave.

### **c) Zyra e shpërndarjes**

Gjatë kësaj periudhe, nga kjo zyrë janë kryer këto punë:

- janë shpërndarë 49554 fatura tatimore për tatimpaguesit,
- për vitin vijues kanë mbetur për shpërndarje edhe 587 fatura, kryesisht në enklava dhe në objektet të cilat nuk kanë qenë mirë të adresuara,
- janë shpërndarë 18250 letërkujtesa për tatimin në pronë.

### **d) Bordi i ankesave**

Bordi i ankesave ka pranuar 1545 ankesa, prej të cilave janë shqyrtuar 1454. 1210 ankesa u janë dërguar për shqyrtim komisioneve në terren, më qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike. Ankesat e shqyrtuara me kohë janë dërguar për regjistrim në zyrën për operim kompjuterik.

### **Arka**

Gjatë vitit raportues, përmes arkës së Komunës janë inkasuar 138.845.33 €.

## **2. Sektori i Pronës**

### **a) Oferta**

Për deklarin nga ana e Komunës për blerjen ose mosblerjen të patundshmërisë (shtëpi, banesë, lokal afaristë, garazh), në vitin raportues janë paraqitur 1123 kërkesa. Nga ky numër i kërkesave, për 1020 kërkesa është kthyer përgjigje. Për vitin vijues janë bartur 103 kërkesa.

Janë inkasuar 3369.00 €.

### **b) Transaksioni i pronës**

Gjatë kësaj periudhe janë bërë 2543 kërkesa për transaksion të pronave (shtëpi, banesa, lokale afariste, garazhe). Prej tyre janë zgjidhur 2510 kërkesa, për vitin vijues në procedurë kanë mbetur edhe 33 kërkesa.

Janë arkëtuar 482.388.88 € dhe kanë mbetur pa u arkëtuar edhe 5800 €.

### **c) Uzurpimet**

Për shqyrtim janë pranuar 188 kërkesa nga lëmi i uzurpimeve: uzurpimet në pjesë të rrugëve dhe të pronës shoqërore, ndërsa një numër i kërkesave është paraqitur për lëshimin e provave nga evidenca të cilat i mbanë Sektori i pronës.

Janë zgjidhur 155, në procedurë për bartje në vitin vijues kanë mbetur 33 kërkesa.

### **d) Të ndryshme**

Komisioni për evidencimin e pronës së uzurpuar, gjatë vitit 2005 ka ka evidencuar 333 raste të uzurpimeve të një sipërfaqeje të tërësishme prej 17.15.54 ha.

Për të gjitha rastet e konstatuara janë bërë matjet e përafërta të sipërfaqeve publike të uzurpuara (pa instrumente për matje precize), janë përpiluar procesverbalet për gjendjen e

konstatuar, dhe janë ftuar palët për të marrë pjesë në procedurë. Dosjet përkatëse i janë dërguar Drejtoratit të Financave dhe të Pronës për veprime të mëtejme procedurale.

Janë evidencuar edhe disa raste të uzurpimeve të pronës shoqërore, të cilat nuk janë përfshirë në këtë raport, sepse nga hartat gjeodezike në të cilat është bazuar konstatimi, është vërtetuar se këto prona kanë qenë në pronësi komunale. Mirëpo, me veprime legale, kjo pronë iu është dhënë në shfrytëzim organizatave të ashtuquajtura “të punës së bashkuar” dhe ndërmarrjeve tjera të atëhershme si ndërmarrje komunale, me të cilat organizata dhe ndërmarrje, bashkë me tokën e dhënë në shfrytëzim, tani menaxhon AKM-ja. Për këto raste komisioni ka hequr dorë nga vazhdimi i punës për konstatimin e shfrytëzuesit ilegal të kësaj prone, deri në rregullimin e marrëdhënieve pronëso-ro-juridike të Komunës për ato prona. Si vështirësi në punën e këtij komisioni ka qenë mungesa e hartave të reja gjeodeze dhe mungesa e evidencave për ndryshimet legale të shfrytëzimit të kësaj prone pas viteve '62, vërtetimi i identitetit të personave uzurpatorë dhe mungesa e logjistikës tjetër, të nevojshme për matje precize të pjesëve të ngastrave kadastrale të uzurpuara.

Në pajtim me dosjet e dorëzuara drejtorisë, Sektori i pronës ka nxjerrë dhe dorëzuar 130 aktvendime, me të cilat është urdhëruar lirimi i pronës së uzurpuar, ndërsa për 20 raste të uzurpimeve, i janë dorëzuar dosjet avokatit komunal për paraqitjen e kallximeve penale ndaj uzurpatorëve. Si propozim të masave për punën e mëtejme të komisionit, konsiderojmë se është e nevojshme që komisioni të përkrahët me logjistikë të nevojshme, përkatësisht me sigurimin e instrumenteve për matje gjeodezike, foto-aparate për incizimin e gjendjes faktike në terren, në mënyrë që këto dosje të jenë sa më të kompletuara, si dhe të ndihmohet Komisioni me shënime të nevojshme nga organet tjera ekzekutive për statusin dhe llojin e pronës në pronësi komunale. Në këtë mënyrë nuk do të humbet kohë me evidencimin e pronës së uzurpuar, për të cilën Komuna ka humbur të drejtën e pronësisë me dhënien në shfrytëzim të asaj prone ish-ndërmarrjeve komunale, apo ish-organizatave tjera të punës së bashkuar.

### **3. SEKTORI I FINANCAVE**

#### **Analiza e shpenzimeve buxhetore**

Meqenëse në çdo fundvit bëhet paraqitja e raporteve të shpenzimeve buxhetore, Drejtorati i Financave dhe i Pronës, gjegjësisht Shërbimi i financave ka përgatitur këtë raport mbi shpenzimet buxhetore, duke krahasuar planifikimin në raport me shpenzimet.

Fillimisht duhet theksuar ndryshimet buxhetore që janë bërë në nivel qendror, ku në kuadër të Komunës, gjegjësisht në Departamentin e Administratës së Përgjithshme janë bërë shkurtimet buxhetore për 44.59% , e nëse llogaritet në total buxheti i ndarë nga granti, shkurtimi buxhetor ka qenë 26.76%. Ndërkaq, sipas të dhënave, buxheti për vitin 2005 është realizuar 75% të mjeteve buxhetore.

#### **ANALIZA E SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR VITIN 2005**

**Pagat dhe mëditjet** – Në Administratën komunale viti 2005 është përfunduar me numër të të punëtorve 620, duke mos llogaritur departamentet, si Arsimi, Shëndetësia, Zjarrfiëksit dhe Zyra lokale e Komuniteteve.

Shpenzimet në kategorinë për paga dhe mëditje janë plotësuar dhe shpenzuar siaps numrit të planifikuar me buxhet.

**Shpenzimet materiale** – Këto shpenzime hyjnë në kategorinë ekonomike për mallra dhe shërbime, pjesëmarrja nga granti është përfshirë me 2.53%, ndërsa nga të hyrat 0.14%.

Shikuar nga këndi i planifikimit të shpenzimeve materiale, shpenzimet janë të shkallës normale, duke u zvogëluar në krahasim me shpenzimet kapitale. Llogaritur sipas përqindjës, shpenzimet materiale arrijnë në 88.32%, duke pasur parasysh se prerja buxhetore ka bërë ndryshimet në strukturën e planifikimit në raport me shpenzimet.

**Pajimet** – Është njëra nga fushta që ka ndryshime bazuar në raportin e planifikimit me shpenzimet, mjetet e ndara nga granti, rreth 1.0%, janë tejkaluar në krahasim me shpenzimet, prandaj, me prerjen buxhetore është bërë ndryshimi i krahasimit në raport me planifikim-shpenzim. Pas prerjes buxhetore ndryshimi është përqëndruar në përqindjen e realizimit të shpenzimeve prej 93.22% .

**Shpenzimet komunale** – Pjesëmarrja e ndarjes së mjeteve nga granti është mbuluar mbi 1%, ndërsa shpenzimet janë rritur në krahasim me planifikimin, por përmes rishikimit buxhetor janë bërë plotësimet dhe ndryshimet buxhetore, ku shpenzimet buxhetore janë realizuar 96%.

**Autoparku** – Në bazë të shënimeve në dispozicion vërehet se nga mjetet buxhetore të planifikuara, kuota e paraparë nuk ka mjaftuar, andaj mjetet e planifikuara nga granti dhe të shtuara nga të hyrat vetanake, kanë ndryshuar shpenzimet buxhetore. Kemi pasur parasysh se kapaciteti i automjeteve është jo i kënaqshëm për kryerjen e shërbimeve. Kur e themi këtë duhet theksuar se pjesa më e madhe e automjeteve janë të amortizuara në shkallë të lartë, që nënkupton se edhe hargjimet janë më të mëdha.

**Shërbimet e përgjithshme** – Marrë përgjithësisht strukturën përbërse të shërbimeve të përgjithshme, përbëhet me një renditje jo të ndërlidhur, të ndarë në tri pjesë:

*Pjesa e parë:* kompensimi i anëtarve të Kuvendit dhe të Komiteteve;

*Pjesa e dytë:* shërbimet e intrenetit, shpalljet dhe konkurset, dhe

*Pjesa e tretë:* shërbimet tjera që përfshijnë një gamë të gjërë të shpenzimeve tjera, si: transporti i minoriteteve, transporti i kufomave, ndihmat e ndryshme, drekat zyrtare, sigurimi fizik, transporti i nxënësve, bufeja, provizioni bankar etj..

Prandaj, pas prerjes buxhetore struktura krahasuese e shpenzimeve në raport me planifikimin, është realizuar mbi 96% të mjeteve të shpenzuara buxhetore.

**Shërbimet publike** – Është një ndër fushat që më së shumti është prekur nga shkurtimet buxhetore-kategoria për mallra dhe shërbime, përveç kategorisë për shpenzime kapitale, që më së shumti ka pësuar zvogëlim. Këto shërbime janë tejet me rëndësi kur kemi parasysh qëllimin e funksionit të tyre, kryesisht me infrastrukturë për mirëmbajtje vjetore. Me anë të prerjes buxhetore, krahasimi i mjeteve të ndara buxhetore planifikuese në raport me shpenzimet, janë realizuar mbi 87% të mjeteve buxhetore sipas projekteve për shërbime publike-mirëmbajtja e infrastrukturës shërbyese.

## **INVESTIMET KAPITALE**

**Administrata e Përgjithshme** – Mjetet e planifikuara buxhetore janë ndarë tërësisht nga të hyrat vetanake rreth 8%, ndërkaq shpenzimet buxhetore janë përfshirë nga projektet në fjalë mbi 96%.

**Drejtorati i Shërbimeve Publike** – Është një ndër drejtoritë që bart barrën dhe përgjegjësinë për zhvillimin, rikonstruktimin dhe ndërtimin e infrastrukturës në kryeqytet me rrethinë. Mjetet e ndara sipas planifikimit të buxhetit janë përfshirë nga granti rreth 12% dhe nga të hyrat vetanake 46%. Ndërkaq, duke pasur për bazë këtë ndarje, shpenzimet

buxhetore janë realizuar 68% të mjeteve buxhetore. Është për të theksuar se shkurtimi buxhetor këtu ka ndikuar më së shumti, pikërisht në këtë kategori ekonomike. Duhet theksuar se shuma prej 1,323,630 €, mbetet ende pa u realizuar dhe bartet për pagesë në vitin vijues.

**Inspeksioni** – Detyrat dhe obligimet e kësaj fushe janë përmbushur nga aktivitetet në terren dhe si rezultat i kësaj janë shpenzimet plotësuese, pikërisht nga prerja buxhetore. Mjetet e ndara buxhetore tërësisht janë mbuluar nga të hyrat vetanake. Pjesëmarrja e ndarë nga të hyrat ka qenë rreth 1%, ndërkaq shpenzimet buxhetore janë realizuar mbi 93% të mejteve.

**Zhvillim Rural** – Prishtina si kryeqytet mbanë përgjegjësin për zhvillimin dhe kujdesin ndaj hapësirës rurale. Projektet e e paraqitura në tabelë tregojnë për një mori aktivitete që janë zhvilluar në pjesët rurale, në kuadër të blegtorisë, perimtarisë dhe infrastrukturë rurale. Ndajra lineare buxhetore është bërë rreth 5% nga granti dhe mbi 9% nga të hyrat vetanake, ndërsa kundruall planifikimit, shpenzimet buxhetore janë realizuar mbi 89% e mjeteve buxhetore.

**Arsimi** – Në bazë të instruksionit administrativ, Komuna mbanë përgjegjësinë për ndarjen e mjeteve buxhetore nga granti dhe nga të hyrat vetanake për sektorin e arsimit, gjegjësisht për kategorinë e investimeve kapitale. Pjesëmarrja nga granti për sektorin e arsimit është mbi 16%, kurse nga të hyrat vetanake mbi 11%. Nga mjetet e ndara buxhetore, për projekte kapitale janë realizuar mbi 52%. Nga përqindja e realizimit të projekteve është menduar që sadopak të mbrohen intresat parësore në Sektorin e arsimit.

**Kulturë dhe Gjini** – Përkrahja ndaj fushës së kulturës është munduar të mbahet paralel me mundësitë e mbështetjes për projektet kapitale dhe aktivitetet tjera kulturore. Ashtu si planifikimi, edhe shpenzimi është mbështetur nga granti komunal, siaps planifikimit rreth 4% nga granti, ndërkaq shpenzuar rreth 41 % të mjeteve buxhetore.

**Rini dhe Sport** – Projektet dhe mbështetja për aktivitetet sportive të rinisë janë ndarë tërësisht nga granti me mbi 4%, kundruall kësaj sipas projekteve buxhetore janë realizuar mbi 78% të shpenzimeve.

**Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale** – Për fushën e investimeve kapitale, Komuna ndanë mjete buxhetore nga granti me rreth 5%, ndërsa nga të hyrat vetanake mbi 5%. Duke shikuar anën tjetër, gjegjësisht shpenzimet kapitale vjetore, ky drejtorat, në projektet kapitale ka tejkaluar realizimin mbi 1% të mjeteve buxhetore, gjegjësisht 102% janë realizuar projektet kapitale. Duhet theksuar se mjetet e destinuar për disa projekte janë ridestinuara për projekte sipas planit të drejtoratit në fjalë.

**Urbanizëm dhe Planifikim** - Pasiqë ky drejtorat mban përgjegjësinë për strategjinë e planifikimit urban, mbështetja i jepet nga të hyrat vetanake komunale. Është menduar se këto projekte krahas planifikimit dhe miratimit, të krijojnë sa më shumë të hyra komunale. Nga shuma e planifikuar e mjeteve buxhetore prej rreth 3%, janë shpenzuar mbi 83%.

**Emergjencia – Zjarrfikësat** – Komuna, si e tillë, deri më tani ka përkrahur Sektorin e zjarrfikësve brenda mundësive buxhetore lineare. Pjesëmarrja në grant është përfshirë me mbi 5% të mjeteve buxhetore për projektet me prioritet. Kjo drejtori buxhetin e ka realizuar mbi 74% të shumës së ndarë.



**Ekonomia** – Duke pasur për bazë ndarjen e mjeteve buxhetore nga granti, Drejtorati i Ekonomisë është mbështetur me rreth 1% të mjeteve të planifikuara buxhetore, ndërkaq janë realizuar mbi 16% të mjeteve buxhetore nga projektet kapitale me prioritet.

**Financa** – Mjetet e ndara nga të hyrat vetanake janë destinuar për infrastrukturë në qytet, për mbështetjen e projektit nga tatimi në pronë.

**Hartimi i projekteve kapitale** nga shtëpitë projektuese, në kuadër të komunës janë ndarë rreth 3% dhe shpenzuar mbi 57% të mjeteve buxhetore nga të hyrat vetanake.

**Fatëkeqësitë natyrore**, fatmirësisht nuk janë shprehur në shkallë vendi të alarmimit, prandaj mjetet e ndara nga granti janë ridestinuuar dhe shpenzuar në proporcion për zjarrfikës dhe infrastrukturë.

**Zyra lokale për minoritete** – Nga projektbuxheti i planifikuar dhe i ndarë për shpenzime me prioritet për minoritetet, rreth 8% janë ndarë nga granti, por disa projekte janë mbuluar edhe nga të hyrat vetanake komunale. Këto të dhëna gjithësesi janë të paraqitura edhe në raportet periodike për ndarjen e drejtë financiare. Shpenzimi i realizuar për projektet me prioritet në vendbanimet me popullatë jo shumicë, është realizuar mbi 98%, duke u bazuar në projektet me prioritet.

## **IV. DREJTORATI I SHËNDETËSISË DHE I MIRËQENIES SOCIALE**

Puna e Drejtoratit të Shëndetësisë dhe të Mirëqenies Sociale është kryer nga Sektori për shëndetësi, Sektori për shëndetin publik dhe Sektori për mirëqenie, ku bënë pjesë edhe Shërbimi për strehim social. Shërbimet shëndetësore ofrohen në 10 qendra të Mjekësisë Familjare, në 15 ambulanca shëndetësore në viset rurale, në 10 ordinanca stomatologjike në shkollat fillore të qytetit, si dhe në Entin për Ndihmë të Shpejtë Mjekësore. Gjatë vitit 2005 furnizimi me barnra, material tjetër shëndetësor dhe karburante ka qenë i kënaqshëm.

### **1. SEKTORI I SHËNDETËSISË**

#### **Projektet e realizuara dhe në ndërtim e sipër:**

- renovimi dhe pajisja me aparaturë dhe inventar e Poliklinikës Stomatologjike (510.000,00 €), e përruar më 20. 06. 2005. Bashkinvestitor ish-in Ministria e Shëndetësisë 125.000,00 € dhe Drejtorati i Shëndetësisë 385.000, €,
- renovimi dhe pajisja me inventar e QMF V në Dardani (320.000,00 €), e përruar më 21. 06. 2005, investitor Drejtorati i Shëndetësisë,
- ndërtimi i QMF në Mat (320.000,00 €), bashkëinvestitor CDF-ja 86.000,00 € dhe Drejtorati i Shëndetësisë 234.000,00 €, përruar më 02. 07. 2005,
- ndërtimi i QMF në Kalabri (346.000,00 €), investitor Drejtorati i Shëndetësisë,
- në ndërtim e sipër, QMF në lagjen "Kodra e Trimave" (244.755,56 €), Drejtorati i Shëndetësisë,
- në ndërtim e sipër, Ambulanca Shëndetësore në Llukar, (33.780,00 €). Drejtorati i Shëndetësisë,
- riparimi dhe adaptimi i hapësirave për mjekësinë familjare në QKMF (35.000,00 €), donacionet nga OBSH-ja,
- riparimi dhe ngjyrosja e objektit të Ambulancës Shëndetësore në Keqekollë, 7.200,00 €, Drejtorati i Shëndetësisë,
- riparimi dhe ngjyrosja e obj. të Ambulancës Shëndetësore në Kishnicë, (5.800,00 €), Drejtorati i Shëndetësisë,
- blerja e dy autoambulancave me pajisje (78.000,00 €), donacion nga Qeveria japoneze,
- Blerja e një autoveture zyrtare për QKMF-në (14.801,00 €), Drejtorati i Shëndetësisë,
- blerja e një autoveture për terren (9.800,00 €), Drejtorati i Shëndetësisë,
- furnizim me inventar shëndetësor për QKMF-në (71.404,00 €),
- blerja e gjeneratorit për QKMF-në (31.000,00 €) etj.,
- dezinfektimi hapësinor i Prishtinës (97.750,00 €), Drejtorati i Shëndetësisë,
- deratizimi pranveror i garazheve dhe podumeve publike të qytetit të Prishtinës (37.850,00 €), Drejtorati i Shëndetësisë,
- deratizimi vjeshtor i garazheve, podumeve dhe rrjetit të kanalizimit të qytetit të Prishtinës (96.100,00 €), Drejtorati i Shëndetësisë,
- ndihmë shoqatave me nevoja të veçanta dhe rasteve të rënda sociale 60.000,00 € Drejtorati i Shëndetësisë.

### **2. SEKTORI PËR MIRËQENIE SOCIALE**

Punët dhe prioritetet e këtij sektori brenda vitit raportues:

- identifikimi i rasteve të rënda sociale në komunën tonë.

- pranimi, seleksionimi, shqyrtimi dhe vendosja në procedurën administrative e kërkesave të parashtruara këtij sektori gjatë vitit 2005 arrin në 525 kërkesa
- shqyrtimi i kërkesave të parashtruara për ndihmë të përkohshme emergjente në të holla të gatshme pa kthim; prej tyre janë aprovuar 23 kërkesa, me shumën prej 2.370,00 €, ndërsa janë refuzuar 57 kërkesa,
- kërkesa të parashtruara për ndihmë emergjente në gjëra ushqimore për shkak të mbetjes momentale pa ushqim të domosdoshëm për jetë, gjithsejtë 369. Prej tyre 262 janë shqyrtuar pozitivisht, në shumën 13.100,00 €, kurse 107 janë refuzuar,
- pranimi i palëve në këtë sektor dhe ofrimi i ndihmës së nevojshme profesionale dhe juridike,
- hartimi i instruksioneve dhe formulave për realizimin më efikas të të drejtave të palëve që i drejtohen këtij sektori,
- verifikimi i gjendjes së përgjithshme sociale të familjeve në varfëri të skajshme dhe të rrezikuara materialisht,
- kontaktet dhe takimet me nivelin qendror, atë ndërkombëtarët dhe shoqatat e ndryshme joqeveritare të Kosovës,
- përpilimi i projekteve të ndryshme dhe realizimi i tyre, si p. sh. ofrimi i ndihmave emergjente në ushqim, barna, shpërndarja e dhuratave fëmijëve bonjakë për Vitin e Ri dhe projekte të tjera që mundësohen nga ana e sektorit tonë.

**PASQYRA TABELARE E PUNËVE TË DREJTORISË  
PROJEKTET E PARAPARA PËR VITIN 2005 DHE TË REALIZUARA:**

1).(69), Dezinfektimi hapësinor i Prishtinës 2005.....	97.750,00 €
2).(70),Deratizimi vjeshtor i kanalizimit dhe i garazheve të Prishtinës .....	96.100,00 €
3).(72, 80).Fond i veçantë për ndihmë në barna, ushqim dhe ndërtim.....	21.970,00 €
4).(73) Deratizim pranveror i podumeve dhe garazheve të Prishtinës.....	37.850,00 €
5).(76) Renovimi i Ambulancës Shëndetësore në Keqekollë .....	7.200,00 €
6).(78)Rrëni dhe ndërtimi i Ambulancës Shëndetësore në f. Llukar.....	33.780,00 €
7).(81) Fond i veçantë për ndihma shoqatave me nevoja të veçanta.....	60.000,00 €
8).(18) Blerja e dy autovecurave për QKMF.....	24.601,00 €
9).(19) Blerja e dy ap. shënd. ( analajzer dhe monitor).....	17.520,00 €
<b>T o t a l i : .....</b>	<b>396.771,00 €</b>

**PROJEKTETE E PARAPARA PËR VITIN 2005 DHE TË PAREALIZUARA:**

1).(71) Ndërtimi I ob. të Ambulancës Shëndetësore në Shkabaj.....	90.000,00 €
2).(74) Rregullimi i rrethojës së QMF V .....	40.000,00 €
3).(75) Rregullimi i rrethojës së QMF VI .....	40.000,00 €
4).(77) Ndërtimi i mbulojës së autoparkut në ENSHM .....	70.000,00 €
5).(76).Dezinsektimi kërrpushor i hapësirave në rast nevoje .....	20.000,00 €
<b>T o t a l i : .....</b>	<b>..260.000,00 €</b>

Këto projekte të cilat nuk janë realizuar në këtë vit, janë bartur për vitet tjera. Kjo bartje është bërë për arsyen e vetme sepse për vitin 2005 ka qenë me prioritet ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare në Kodrën e Trimave dhe projekti i saj sipas marrëveshjes është dërguar në AER për ta financuar ata (si donacion), por, për këtë vit AER-i i ka dhënë përparësi projektit komunal të Arkivit të Qytetit dhe ne e kemi kthyer menjëherë këtë projekt në drejtorat dhe e kemi proceduar me prioritet ashtu siç ka qenë i paraparë. Projekti në fjalë është në fazën përfundimtare të ndërtimit.

## PROJEKTET TJERA TË REALIZUARA NGA MJETET TJERA BUXHETORE PËR SHPENZIME KAPITALE GJATË VITIT 2005 :

1).Ndërtimi i QMF Kodra e Trimave .....	244.755,56, €
2).Blerja e gjeneratorit për QKMF .....	31.000,00 €
3).Ndërtimi dhe rregullimi i rrethojës së QMF në Matiqan .....	16.186,00 €
4).Riparimi ngjyrosja dhe paisja në A. Shëndetësore – Kishnicë .....	5.800,00 €
5).Furnizim me inventar shëndetësor për QKMF .....	71.404,00 €
6).Fur. dhe vendosja e antenës kryesore në ENSHM .....	6.578,00 €
7).Fur. dhe vendosja e dhjetë antenave në inat. shëndetësore parësore.....	9.642,75 €
8).Deratizimi i institucioneve shëndetësore parësore .....	5.002,00 €
9).Furnizim me ormanë special për stomatologji .....	9.410,00 €
10). Ndërtimi dhe rregullimi i parkingut dhe oborrit në DSM .....	9.869,52 €
11). Furnizimi dhe montimi i tetëmbëdhjetë klimave për ordianca.....	5.850,00 €
12). Furnizimi dhe montimi i makinës për larjen dhe tharjen e teshave.....	9.526,00 €
13). Punët përfundimtare në renovimin e QMF V .....	25.405,00 €
<b>T o t a l i .....</b>	<b>451.028,83 €</b>

### TOTALI – INVESTIME KAPITALE - 2 0 0 5

**I PARAPARË 834.200,00 €, I REALIZUAR 847.799,83 €, APO 101,63 %**

## V. DREJTORATI I ARSIMIT DHE I SHKENCËS

Objektivat kryesore të punës së Drejtoratit të Arsimit dhe të Shkencës, gjatë vitit 2005, kanë qenë:

- angazhimi për realizimin e projekteve të ndryshme të ndërtimit, rindërtimit dhe meremetimit të objekteve të ndryshme shkollore të komunës së Prishtinës,
- sigurimi dhe plotësimi i kuadrit mësimor dhe mbështetës për vitin shkollor 2004/2005, në bazë të nevojave dhe të kërkesave nga drejtorët e institucioneve arsimore dhe mbështetja për trajnimin e kuadrit udhëheqës dhe arsimor të institucioneve arsimore nga MASHT-i dhe organet tjera joqeveritare /KEC-i, etj./,
- realizimi i aksionit tradicional “Garat e diturisë” në nivel komunal, organizimi dhe realizimi i manifestimit “Garat e recitatorëve” në nivel komunal, organizimi dhe mbajtja e manifestimit “Maturiada e Prishtinës 2005”,
- sigurimi i udhëtimit për nxënësit e kl. IX dhe arsimtarët nga viset rurale ,
- sigurimi i lëndëve djegëse për sezonin dimëror, me anë të tenderëve të shpallur për dru, qymyr dhe naftë, për nevojat e nxemjes për objektet shkollore,

Realizimi i këtyre objektivave është bërë nga tri shërbime të veçanta, që veprojnë në kuadër të Drejtoratit të Arsimit dhe të Shkencës, dhe nga stafi menaxhues i Drejtoratit.

### Ndërtimet dhe meremetimet:

Gjatë vitit 2005 Drejtorati i Arsimit dhe i Shkencës është angazhuar që t'i përmbushë objektivat, të cilat i ka përcaktuar me prioritet në planin operacional.

Renovimet e ndryshme:

1.Ndërrimi i dritareve.....	222.265,10
2.Ngjyrosja e shkollave.....	80.593,58
3.Renovimi i nyjave sanitare .....	174.246,80
4.Renovimi i ngrohjes qendrore .....	80.000,00
5.Renovimi i dysHEMEVE lotto I.....	87.943,38
6.Renovimi i dysHEMEVE lotto II.....	149.472,90
7.Renovimi i kulmeve .....	189.329,30
8.Ndërtimi i rrethojave .....	82.658,74
9.Renovimi i dhomave të mësimit .....	23.400,00
10.Renovimi i rrymës në SHF."Gjergj Fishta".....	8.900,00
11.Renovimi i klasave të minoriteteve.....	4.982,00
12.Furnizimi i shkollave me mjete konkretizuese.....	<u>199.849,30</u>
	1.303.640. €

Furnizimi i shkollave me inventar .....	142.897,85 €
Furnizimi i shkollave me lëndë djegëse(dru, thëngjill, naftë):.....	649.000,00 €

***Projektet që nuk janë realizuar dhe kanë qenë të planifikuara gjatë vitit 2005:***

1. Ndërtimi i shkollës në L.e Vreshtave.....	750.000,00
2. Ndërtimi i shkollës në fshatin Llukar.....	350.000,00
3. Ndërtimi i terreneve sportive ne disa shkolla.....	47.000,00
4. Ndërtimi i katit të dytë të sh.f."N.Tereza" Vranidoll.....	30.000,00
	<u>1.177.000,00 €</u>

1.177.000,00 € buxhet që duhet të realizohet ne vitin 2006, ose kërkim në donacione tjera.

Janë bërë takime pune me përfaqësuesit e komunitetit serb të Graçanicës, bashkë me UNMIK-un, lidhur me reduktimin e punëtorëve si tepricë ekonomike.

***Zbatimi i reformës arsimore***

Meqenëse në këtë vit shkollor është filluar edhe më klasat VI, VIII, dhe, XII, në kuadër të drejtorisë është vazhduar edhe më tej me punët për realizimin e reformës në arsim, duke i mbështetur dhe përkrahur nismat për reformat edhe në fushën e arsimit nëpërmjet trajnimeve të ndryshme të arsimtarëve të të gjitha niveleve të arsimit. Në trajnime kanë marrë pjesë gjithnjë edhe një numër i zyrtarëve të arsimit të të gjitha niveleve.

Për sigurimin e kushteve sa më të mira për klasën I, II, III, VI, VII, VIII, X dhe XI, XII, Drejtorati i Arsimit dhe i Shkencës, në bashkëpunim me MASHT-in, është angazhuar edhe për furnizimin e këtyre shkollave me inventar dhe mjete mësimore të konkretizimit.

Në bashkëpunim me MASHT-in janë siguruar me kohë planprogramet mësimore për klasën e tretë(III) dhe për klasën e tetë (VIII).

***Mbikëqyrja e tërë sistemit arsimor komunal***

Gjatë vitit në raportim, është bërë mbikëqyrja e zhvillimit të tërë sistemit arsimor komunal, në të gjitha nivelet, duke filluar nga drejtori me personelin e vet, Shërbimi për punë të përgjithshme administrative dhe Shërbimi i zyrtarëve arsimorë.

Sistemin arsimor të Komunës së Prishtinës e përbëjnë:

Institucionet	Numri	Mësimdhënës	Per.admn.	Per.ndihmës	Gjithsej	Numri i nxënësve		
						Shqip.	Min.	Gjithsej
Parashkollore	09	185	19	90	294	1666	373	2039
Filllore	41	1680	92	289	2061	34027	1197	35224
Të mesme	12	684	35	140	859	10060	1642	11702
Gjithsej	62	2549	146	519	3214	45743	3212	48965

Gjatë vitit 2005 janë mbajtur 14 mbledhje me drejtorët e institucioneve edukativo-arsimore, në të cilat janë trajtuar çështje të ndryshme për mbarëvajtjen menaxhuese të punës edukativo-arsimore, në të gjitha nivelet e punës edukativo-arsimore, dhe janë dhënë udhëzime të nevojshme për kryerjen e detyrave dhe obligimeve konkrete, në harmoni me trendin zhvillimor të arsimit në komunës së Prishtinës.

Gjatë vitit 2005, nga drejtori i Drejtoratit të Arsimit dhe të Shkencës dhe shefat e sektorëve, janë bërë rreth 127 vizita me karakter pune në të gjitha institucionet shkollore të komunës së Prishtinës: të nivelit parashkollor, fillor dhe të mesëm.

### **Shërbimi i zyrtarëve arsimorë**

Zyrtarët e arsimit të Komunës së Prishtinës, gjatë vitit 2005 kanë bërë vizita të rregullta, speciale e kontrolluese në nëntë drejtoritë e institucioneve parashkollore, në 37 shkolla fillore me mësim në gjuhën shqipe, bashkë edhe me 23 paralele të ndara të tyre, në një shkollë speciale, si edhe në 12 shkolla të mesme.

Vizitat kanë qenë të fokusuar në mbarëvajtjen e procesit mësimor, duke e kontrolluar në tërësi punën edukativo-arsimore me nxënës, vlerësimin e tyre, vijimin e mësimin, masat edukative, procedurën e pranimit të kuadrit mësimor, disiplina në punë, realizimi i planit dhe programit mësimor e tjera. Kujdes të veçantë i është kushtuar aplikimit të klasave I, II, III, VI, VII, VIII, X, XI dhe XII, dhe mënyrës së organizimit të procesit mësimor me këto klasa. Përveç vizitave të rregullta, zyrtarët arsimorë kanë bërë edhe 27 kontrollime speciale, 23 vizita kontrolluese dhe 54 kontrollime në bazë të ankesave të nxënësve, arsimtarëve, punëtorëve dhe të tjerëve.

Pos punëve të tjera zyrtarët arsimorë janë angazhuar edhe në punët me palë, duke dhënë udhëzime për realizimin e kërkesave të tyre.

Gjatë vitit 2005 janë bërë edhe 11 vizita informative në shkollat fillore, 9 vizita informative në shkollat e mesme dhe 3 vizita informative në nëntë drejtoritë e institucionit parashkollor. Gjatë vitit 2005, nga zyrtarët arsimorë, janë përcjellë punëtoritë dhe seminarët e organizuara nga MASHT-i dhe nga organizatat tjera qeveritare dhe joqeveritare, për aftësimin e kuadrit dhe për realizimin e reformës shkollore.

### **Shërbimi i përgjithshëm administrativ**

Gjatë vitit 2005 Shërbimi i përgjithshëm administrativ ka kryer këto detyra dhe shërbime:

- ka bërë shpërndarjen e listave të pagave për të gjitha institucionet edukativo-arsimore: parashkollore, fillore dhe të mesme,
- plotësimin dhe shpërndarjen e formularëve të ndryshëm për pagat e arsimtarëve dhe të punëtorëve të tjerë arsimorë,
- pranimin e faturave të ndryshme për shpenzime materiale dhe pagesa të tyre,

- takime pune me zyrtarët e UNMIK-ut lidhur me nevojat e furnizimit të shkollave me lëndë djegëse, për sezonin dimëror,
- përpilimin e planit financiar afatmesëm për vitin shkollor 2003/2005, për të gjitha shkollat e komunës së Prishtinës, shpërndarjen dhe pranimin e aplikacioneve për vendet e lira të punës, në bazë të kërkesave nga Drejtorati për Arsim dhe Shkencë,
- përpilimin e shkresave të ndryshme,
- shtypjen e materialeve të ndryshme.

### **Shërbimi financiar për mallëra dhe shërbime:**

Nga ky shërbim janë kryer këto punë:

- është përpiluar raporti financiar për të gjitha nivelet e institucioneve shkollore dhe parashkollore të Komunës së Prishtinës dhe i njëjti raport i është ofruar të gjitha drejtorive të shkollave,
- është menaxhuar me buxhetin e Arsimit të Prishtinës,
- janë mbajtur shënime dhe janë përcjellë të gjitha faturat për shpenzimet (përveç atyre kapitale) e mjeteve financiare për të gjitha shkollat dhe për institucionin parashkollor,
- janë mbajtur shënime për të hyrat vetanake të shkollave dhe të institucionit parashkollor,
- është bërë zotimi i mjeteve financiare,
- është nxjerrë gjendja e buxhetit të Arsimit,
- janë njoftuar me kohë( me shkrim) organet kompetente komunale dhe të MEF-it, për problemet me të cilat po ballafaqohet Arsimi i Prishtinës. Me organet e lartshënuara janë mbajtur takime me qëllim të zgjidhjes së këtyre vështirësive.
- është përpiluar propozimplani për buxhetin e Arsimit për vitin 2006,
- është përcjellë buxheti për paga të punëtorve të arsimit ,
- janë marrë masa për largimin nga lista e pagave për të gjithë punëtorët e arsimit ( punëtorët e arsimit të minoritetit serb ), të cilët kanë realizuar të ardhura në kundërshtim me ligjin,
- është sistemuar i tërë dokumentacioni i nevojshëm dhe i njëjti është evidentuar edhe në kompjuter,
- janë përpiluar dhe janë plotësuar tabelat për analizën mujore të shpenzimeve,
- është organizuar transporti për arsimtarë dhe nxënës të klasëve të nënta nga qendrat lokal per ne Prishtine dhe anasjelltas,
- është bashkëpunuar me kontrollin financiar të MEF,
- kemi marrë pjesë në kontrollin financiar të disa shkollave dhe të institucionit parashkollore.
- është proceduar për tenderim në Zyren e Prokurimit, për furnizimin e shkollave me material higjienik, material për ujë, material elektrik, material didaktik, rekuizita sportive etj. Mënyrën e inkasimit të mjeteve vetanake të institucionit parashkollor dhe të shkollave që realizojnë mjete nga qeraja. Të gjitha janë nën mbikëqyrje financiare të Sektorit të shërbimit financiar .
- janë vizituar dhe është biseduar me njerëzit kompetentë (te ndërmarrjeve, të cilët i kryejnë shërbimet komunale) me qëllim, që, eventualisht, një pjesë e borxheve të vjetra të shlyhen, ose që pagesa e tyre të bëhet me këste,
- janë kryer edhe shumë punë të tjera dhe vlenë të theksohet, se bashkëpunimi me organet kompetente financiare të Komunës dhe me ato të MEF-it është në nivel .

## **Sigurimi i kuadrit mësimor dhe mbështetës**

Në bashkëpunim me MASHT-in dhe me drejtoritë e shkollave, pos me konkurse të rregullta, kuadrin edukativo-mësimor dhe mbështetës për të gjitha nivelet e arsimit në komunën e Prishtinës, e kemi siguruar edhe përmes pranimit me zëvendësime .

Problemet me të cilat është ballafaquar ky sektor ishin:

- mungesa e kuadrit të kualifikuar në shkollat fillore, për lëndët mësimore: gjuhë angleze dhe kulturë muzikore, si dhe mungesa e kuadrit arsimor për shkollat e mesme për lëndën e matematikës dhe për lëndët profesionale, si inxhinierë të profileve të ndryshme etj.,
- gjendja më e vështirë me kuadër të kualifikuar është në shkollat e fshatrave, sidomos të atyre të largëta në Malësinë e Gollakut, ku është dashur të angazhohjme personel arsimor të pakualifikuar të vendit,
- tani kur kemi siguruar transportimin e nxënësve nga pothuajse të gjitha vendbanimet rurale është krijuar mundësia për transportimin e arsimtarëve nga Prishtina në shkollat rurale, me çka shpresojmë se do të përmirësohet struktura kualifikuese e kuadrit arsimor.

Probleme të veçanta na paraqiten me rastin e zavendësimit të punëtorëve, që shkojnë në pushime mjekësore të shkurtëra, p.sh. për një ose dy javë, nga se punëtorët e pranuar arsimor nuk zgjojnë interesim për t'u angazhuar për kohë të shkurtër. Një gjë e tillë krijon vështirësi edhe për futjen e punëtorëve të tillë në sistemin e pagesave. Këto janë reflektuar drejtpërdrejt në çrregullimin e procesit normal edukativo-arsimor.

## **Mbështetja e trajnimit të kuadrit udhëheqës dhe arsimor**

Gjatë vitit 2005 kujdes të veçantë i është kushtuar edhe trajnimit të kuadrit udhëheqës dhe arsimor, i cili është realizuar në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë, në frymën e reformave arsimore, që po bëhen në Kosovë.

Gjatë muajve prill-maj-qershor, por edhe gjatë sezonit veror, e edhe gjatë muajve shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor 200 janë mbajtur seminare për trajnim të arsimtarëve dhe të stafit udhëheqës të shkollave, të udhëhequra nga MASHT-i, e të mbështetura nga Drejtorati komunal për Arsim, në realizim të KEDP-së dhe të KEC-it.

Seminare për trajnimin e arsimtarëve ka organizuar edhe Shoqata finlandeze për punë me fëmijë me nevoja të veçanta.

Realizimi i “ Garave të recitatorëve ”, “ Garave të diturisë ” në nivel komunal dhe – “Maturiada e Prishtinës 2005”.

Në kuadër të planit të punës që ka bërë kjo drejtori, janë realizuar edhe këto aktivitete:

- garat e recitatorëve dhe garat e diturisë (në tetë lëndë mësimore) në 35 shkolla fillore,
- gjedhja e nxënësit, paraleles, mësuesit, arsimtarit , profesorit dhe edukatores më të mirë të të gjitha niveleve edukativo-arsimore komunale.

Garat e diturisë janë mbajtur më 23. 05. 2005, kurse Garat e recitatorëve janë mbajtur më 07 mars për nder të festës “Ditën e Mësuesit”. Është mbajtur edhe manifestimi “ Maturiada e Prishtinës 2005”.

Shpallja e rezultateve, ndarja e diplomave, e mirënjohjeve dhe e dhuratave modeste është bërë me rastin e 11 Qershorit, Ditës së Prishtinës.

Gjatë muajit shtator, nga drejtoria është bërë organizimi dhe realizimi i eskurzionit me maturanët e shkollave të mesme në Shqipëri, si dhe organizimi i eskursioneve të shkollave fillore dhe të mesme nëpër Kosovë.



Pos kësaj drejtorati ka mbështetur bashkëpunimin e disa shkollave fillore dhe të mesme, të binjakëzuara me shkollat simotra të Shqipërisë dhe të vendeve tjera evropiane.

Bashkëpunim me OQ-të dhe OJQ-të më realizimin e projekteve të tyre nëpër shkolla:

Drejtoria ka bashkëpunuar me organizatat qeveritare dhe joqeveritare për realizimin e projekteve të ndryshme për parandalimin e dukurive negative tek nxënësit, si me Departamentin e të Drejtave të Njeriut, Institutin e Shëndetit Publik të Kosovës, Sektorin për Drejtat e Fëmijëve, Klubin për të Drejtat e Njeriut “Fëmijët për të Drejtat e Tyre”, Teatrin e të Rinjëve të Prishtinës, Qendrën e Pionierëve etj..

## **Organizimi - përvoja dhe perspektiva**

Është bërë edhe organizimi i brendshëm profesional dhe kadrovik në kuadër të Drejtoratit për Arsimit dhe Shkencë.

Pas miratimit të Ligjit mbi shkollimin fillor dhe të mesëm, kompetencat dhe përgjegjësitë janë më të qartësuara, ndonëse ka vend për koment lidhur me çka është ekskluzivisht kompetencë dhe përgjegjësi e Komunës e çka e MASHT-it. Disa çështje, që nuk janë përkufizuar krejtësisht me ligj, rregullohen me Udhëzime administrative nga MASHT-i.

Do theksuar veçanërisht për përgjegjësitë dhe kompetencat në relacion MASHT – Zyre Rajonale – DKA.

Problem në vete ishte edhe mungesa e rregulloreve, të cilat do të kishin përkufizuar të drejtat, detyrat, obligimet dhe përgjegjësitë e punëtorëve dhe të nxënësve në institucionet arsimore, e sidomos rregullorja mbi disiplinën dhe masat disiplinore ndaj punëtorëve arsimorë, administrativë, si dhe rregullorja për masat disiplinore ndaj nxënësve. Shumë prej këtyre rregulloreve janë përpiluar dhe janë në zbatim.

Kërkohej në të ardhmen të shtohet angazhimi dhe efikasiteti në procesin e prokurimit për çështje të ngutshme të intervenimeve në sanimin e avarive të ndryshme të sistemit të ngrohjes, sanitarisë, kanalizimit, e të tjera.

Nje problem qe po manifestohet në praktikë, është mospërkufizimi institucional i përgjegjësive të drejtorëve të shkollave, me që sipas Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm, drejtorët emërohen dhe shkarkohen nga MASHT-i, kurse pagat merren nga komuna, së bashku me të gjithë punëtorët të tjerë arsimorë, kështuqë ka neglizhim në kryerjen e detyrave dhe obligimeve të përcaktuara me ligj. Prandaj është me interes që të përcaktohet me mirë me amandamente ligjore statusi i drejtorëve të shkollave.

Meqenëse jemi në vazhdim të realizimit të reformës arsimore dhe në vitin e ardhshëm shkollor, sipas Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm të Kosovës, në nivelin e Arsimit të Mesëm, në të gjitha shkollat profesionale si dhe në gjimnaz, drejtimi i përgjithshëm, sipas strukturës 3 + 1, do më thënë vazhdohet me klasën e XIII. Nga kjo rrjedh se nga 109 paralele të klasës XII, 60 sish vazhdojnë edhe klasën e XIII, gjë që na përballon me dy probleme shumë serioze: a/ sigurimi i hapësirës shkollore, e cila mungon dhe na krijon probleme për çdo vit shkollor, për përfshirjen e të gjithë nxënësve, që regjistrohen në klasën e dhjetë /X/. Në vitin shkollor 2005/2006 në klasën e nëntë /IX/, vijnë mësimin 3177 nxënës, që pritet të regjistrohen në klasën e dhjetë /X/, në vitin e ardhshëm shkollor. Nga analizat e bëra rrjedh se për rreth 2000 nxënës duhet të sigurohet lokal shkollor,/ sigurimi i kuadrit arsimor, për 90 mësimdhënës të rinj, për të mbuluar gjithë procesin edukativo-arsimor, në vitin e ri shkollor 2006/2007. Gjithashtu edhe inaugurimi i shkollës së re fillore “Hilmi Rakovica” në lagjen “Kodra e Trimave” kërkon punësimin e 10 punëtorëve të rinj, për personelin administrativ dhe mbështetës.

Prandaj, luteni që të gjeni mundësitë për zgjidhjen e këtyre dy problemeve të mëdha, me të cilat do të përballemi vitin e ardhshëm shkollor 2006/2007.

## VI. DREJTORATI I KULTURËS DHE I GJINISË

### PROJEKTET KRYESORE TË REALIZUARA

#### Investimet kapitale:

1.Projekti për renovimin e tetarit "DODONA".....	253.000€
2.Renovimi i Bibliotekës në Kishnicë.....	4.700 €
3.Renovimi I Bibliotekës në Shkabaj.....	3.600 €
4.Vendosja e ulëseve në Amfiteatrin e Pishinës.....	9.900 €

**271.200 €**

#### Veprimtaria botuese:

1.Mbështetje për botime 11 tituj.....	8.000 €
2.Panairi i librit "KOSOVA 2005".....	1.200 €
3.Projektet e shoqërive kulturo artistike .....	14.000 €
4.Projektet e veprimtarisë filmike (shtatë).....	6.000 €
5.Projektet teatrore(me festivale).....	33.500 €

#### Hapja e "Festivalit Re Musica"

1."RE MUZIKA ".....	9.000 €
2."KAMERFEST".....	3.000 €
3."YLBERI I PRISHTINËS".....	19.000 €
4."TALENTËT E MUZIKËS SERIOZE".....	1.500 €
5."FESTLOJA"- DURRËS.....	3.000 €
6."RAPSHA 2005" TUZ.....	2.200 €
7."HASI JEHON".....	1.000 €
8."SKENA UP".....	1.000 €
9."ROK PËR ROK".....	2.000 €
10."I KENDOJMË LIRISË" - KLINË.....	500 €
11."ODA DIBRANE".....	1.000 €

**43.200 €**

1. "Dita e Prishtinës 2005".....	18.000 €
2. "Dita e fëmijëve -1 Qershori".....	6.700 €
3. "Dita e dëshmorëve të Prishtinës".....	1.500 €
4. "Dita e Pavarësisë së SHBA-ve".....	5.800 €
5. "Maturiada".....	4.600 €
6. Sinjali i gjelbër (mbështetje)"Radio Urban FM".....	1.000 €
7."Dita e Fëmijëve të Luftës".....	1.200 €
8."Dita e Mësuesit(Qendra e Pionierëve) .....	donacion
9."Ditëlindja e Bil Klintonit".....	600 €
10."Dita e të Drejtave të Fëmijëve" (mbështetje).....	500 €

11."Dita e Nënave" (mbështetje).....	300 €
12."Krishtëlindja 2005" .....	3.200 €
13."Viti i Ri për Fëmijë 2005" .....	2.900 €
14."Viti i Ri 2005" (mbështetje).....	7.000 €
15."Konsulata Botërore për Paqe" .....	800 €

---

**54.100 €**

**Projektet e Sektorit të gjinisë:**

1. Sa i njihni të drejtat e gruas.....	2000 €
2. Stop dukurive devijuese.....	500 €
3.Aktivite për avansimin e nënave vetëmbajtëse.....	700 €
4.Fuqizimi i gruas dhe integrimi i gruas në shoqëri.....	2000 €
5. Festivali i artizanateve të Kosovës .....	900 €
6.T'i ndihmojmë grate familjare.....	1000 €
7.Dhuna seksuale e bazuar në gjini.....	logjistikë
8.Udhëheqje e bazuar në vlera.....	1200 €
9. Zhvillimi dhe aftësimi i vajzave (në qepje dhe qëndisje).....	500 €
10.Aktivitetet e Asamlesë së femijëve .....	1000 €

---

**9800**

**Institucionet e kulturës**

**Teatri "Dodona"** .....7500 €

**Instituti i Trashëgimisë Kulturore**

Hulumtimet dhe gërmimet arkeologjike.....	5000 €
Ngritja e monumentit të Henry Dynan .....	1400 €

**Arkivi i qytetit**

Përgatitja për renovimin e ob. të Arkivit të Qytetit .....	2510 €
Kutijat arkivore .....	1930 €

---

**4440 €**

**Qendra e Pionierëve**

Qiraja .....	5040 €
Garderoba .....	1200 €

---

**6240 €**

**Biblioteka e qytetit "Hivzi Sylejmani "**

912 tituj të rinj me 548 ekzemplarë.....	18.600 €
Pagesa e rrymës .....	1.200 €

---

**19.800 €**

**Gjithsej shpenzuar .....** **483.980 €**

## VII DREJTORATI I RINISË DHE I SPORTIT

### Projektet e realizuara gjatë vitit 2005

Realizimi i projekteve për vitin 2005 në Drejtoratin e Rinisë dhe të Sportit është bërë në bazë të programit të punës dhe bazuar në buxhetin e ndarë për këtë drejtori. Në procedurën e nxjerrjes së vendimeve për realizimin e projekteve, në tërësi është respektuar rekomandimi i Komitetit për Rini dhe Sport dhe drejtorive të tjera me të cilat kemi bashkëpunuar në finalizimin e projekteve të përbashkëta.

Puna jonë ka qenë e drejtuar në kahe të organizimit të manifestimeve tradicionale për data të rëndësishme dhe ndihma klubeve sportive, të cilat janë të organizuara në komunë.

### 1. SEKTORI I RINISË

Gjatë kësaj periudhe është realizuar projekti “Muaji i Rinisë 2005”, i cili tradicionalisht mbledh në kryeqytet numër të madh të aktivistëve të rinj dhe OJQ-ve rinore, të cilat veprojnë dhe punojnë në Prishtinë. Këtë vit, në këtë aktivitet janë përfshirë afro 15 organizata të të rinjve të cilat kanë prezantuar aktivitetet e tyre në formë të paraqitjeve skenike, të ekspozitave, të takimeve artistike apo me seminare në të cilat janë shtjelluar tema me interes për të rinjtë e qytetit.

Është siguruar pjesëmarrje aktive e rinisë në formulimin e politikave rinore, të cilat janë nxjerrë nga një punëtori njëjavore, në bashkëpunim me MKGJSQJ - Departamentin dhe Rrjetin Rinor të Prishtinës.

### 2. SEKTORI I SPORTIT

Viti 2005 karakterizohet me realizimin e projekteve të cilat kanë pasuruar dhe modernizuar infrastrukturën sportive të komunës së Prishtinës dhe implementimin e Ligjit për sport. Për herë të parë, në Stadiumin e qytetit janë vendosur ulëset moderne, të cilat i plotësojnë standardet e UEFA-së dhe FIFA-së për zhvillimin e ndeshjeve ndërkombëtare dhe janë vendosur reflektorët të cilët Stadiumit të qytetit i japin një pamje Evropiane.

Janë përkrahur aktivitetet ndërkombëtare të sportistëve prishtinas, është financuar shkollimi i kuadrove profesionale sportive dhe është ndihmuar në botimin e literaturës profesionale në lëmin e sportit.

Janë regjistruar 30 klube sportive me status publik, të cilat veprimtarinë e vet sportive e zhvillojnë në komunën e Prishtinës.

Për Klubet e qytetit dhe implementimin e politikave tona programore, problem në vete mbetet mungesa e bashkëpunimit me menaxhmentin e Pallatit të Rinisë dhe të Sportit. Sportistët e Prishtinës ende nuk mund të zhvillojnë aktivitete në këtë pallat. Vazhdimisht mbyllen dyertë e pallatit dhe hapësirat të cilat janë të parapara për sportist shfrytëzohen për qëllime komerciale. Si pasojë e kësaj politike programore të pallatit atje është mbyllur Qendra Rinore e Prishtinës dhe shumë klubeve sportive iu janë marrë hapësirat e punës dhe iu është pamundësuar që të punojnë për përmbushjen e detyrave programore sportive dhe rinore.

Në mundësitë tona buxhetore jemi munduar që të realizojmë dhe të zhvillojmë projekte të përbashkëta me Lidhjen e të Verbërve dhe shoqatën e personave më aftësi të kufizuar “Handikos”. Në fund të vitit është organizuar manifestimi i përmbylljes së aktiviteteve rinore – sportive dhe është bërë shpallja e sportistëve më të mirë të qytetit.

Në këtë manifestim kanë marrë pjesë më shumë se 400 pjesëmarrës. Këtij manifestimi i është dhënë hapësirë e madhe mediale dhe është vlerësuar si një manifestim i vërtetë

sportiv dhe ka shërbyer si pikë takimi e shumë gjeneratave meritore për sportin e Prishtinës.

Projektet të cilat u realizuan gjatë vitit 2005 në Sektorin e rinisë dhe të sportit :

1. Vendosja e ulëseve (16.000 copë) në Stadiumin e qytetit dhe nivelimi i tribunave.....	140.000 €
2. Ndërtimi i terreneve sportive në Hajvali.....	70.000 €
3. Ndërtimi i fushës sportive në Gërmi.....	118.000 €
4. Organizimi i aktiviteteve sportive-rinore për Ditën e Prishtinës 2005.....	6000 €
5. Realizimi i projektit tradicional për të rinj "Muaji i Rinisë 2005".....	5210 €
6. Realizimi i projekteve "Java e Njeriut me Shkop të Bardhë" dhe "Dita ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuar".....	800 €
7. Përkrahje klubeve sportive të komunës me mjete financiare.....	21000 €
8. Turneu i shtatë tradicional i shahut "Hyzri Talla" dhe Shpallja e sportistëve më të mirë të komunës.....	8970 €
9. Organizimi i kampingut për të rinjtë e qytetit të Prishtinës në Batllavë.....	500 €
10. Organizimi i Turneut në futboll të vogël.....	200 €
11. Zhvillimi i Politikave Rinore për vitin 2005.....	1200 €
12. Bursa studentore ( pesë bursa ).....	2700 €
13. Projekti i realizuar nga OJQ "Loti dhe Kujtimi".....	1500 €
14. Projekt i realizuar nga Asamblea e Fëmijëve.....	120 €

**Gjithsej: 376200 €**

## **VIII. DREJTORATI I PLANIFIKIMIT, URBANIZMIT DHE I NDËRTIMTARISË**

Fushëveprimtaria dhe punët e kësaj drejtorie janë bazuar në zbatimin e rregullativës ligjore nga lëmi i planifikimit dhe rregullimit të hapësirës, nga lëmi i ndërtimit të objekteve investive, si dhe rregullativës dhe vendimeve tjera të nxjerra nga Kuvendi i Komunës në bazë të ligjeve në fuqi dhe rregulloreve të UNMIK-ut.

### **I. SEKTORI I PLANIFIKIMIT HAPËSINOR**

Puna parësore e këtij sektori ka qenë pregaditja dhe koordinimi i hartimit të planeve rregulluese, të përcaktuara me detyrat programore për vitin raportues për qasjen e hartimit të planeve rregulluese, të miratuara me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-35-2427, dt. 10.09.2004., duke përfshirë pregaditjen e detyrave programore, pregaditjen e materialit tenderues, pregaditjen e metodologjisë së mbajtjeve të punëtorive, pregaditjen dhe mbajtjen e ekspozitave, diskutimeve publike të këtyre planeve rregulluese, deri në miratimin e tyre.

Në bazë të këtyre detyrave programore i është dhënë prioritet hartimit të këtyre projekteve dhe planeve rregulluese:

1. Projektet për trajektoret e rrugëve unazore: "Të brendshme", "Qendër" dhe "Treni urban".
2. Planet rregulluese për lagjet:

- "Qendra 1",
- "Mati 1",
- "Kalabria",
- "Dodona",

- "Qendra 2",
- "Tophane",
- "Arbëria 3",
- "Qendra -Ulpianë" në Prishtinë".

Janë caktuar detyrat projektuese në bazë të cilave janë shpall ofertat dhe janë zgjedhur fituesit – hartuesit e planeve rregulluese. Sipas këtyre ofertave-tendereve, fitues për hartimin e planeve rregulluese janë zgjedhur këta ofertues- firma projektuese:

- projektet ideore të unazave.....GRI" Berlin - Gjermani",
- p.rr. "Qendra 1", ..... "4M Group LTD" – Londër,
- p.rr. "Mati 1 ", ..... "Hassen Agentur" Eisingen – Gjermani,
- p.rr. "Kalabria" ..... "Construction Management Alliance Kosova",
- p.rr. "Dodona" ..... "Planungsgruppe 4" Berlin Gjermani,
- p.rr. "Qendra 2" ..... "Urban Plus",
- p.rr. "Tophane" ..... "Komunaprojekt" Maribor Slloveni,
- p.rr. "Arbëria 3" ..... "Atele Arkitektura" Prishtine,
- p.rr. "Qendra -Ulpiane" ne Prishtine,.....(sipas konkursit) shifra "HULP-05",

Si përfundim të këtij raporti të punës nga lëmi i planifikimit, paraqesim të dhëna të shkurtra për sipërfaqen e tokës urbane të përfshirë me plane urbanistike në "ha" gjatë kësaj periudhe raportuese dhe gjatësinë e projekteve të rrugëve unazore dhe trajektorit të trenit urban në "km", i cili duket si më poshtë:

#### I. Gjatësi rrugore :

-unaza e brendshme .....	24.68 km,
-unaza qendër.....	7.00 km,
-treni urban .....	12.70 km.

#### II. Sipërfaqe urbane:

-me p.rr. "Qendra 1 ".....	13.00 ha,
-me p. rr."Mati 1 ",.....	184.00 ha,
-me p.rr."Kalabria.. .....	280.00 ha,
-me p.rr. "Dodona.. .....	19.40 ha,
-me p.rr. "Qendra 2" .....	20.00 ha,
-me p.rr. "Tophane.. .....	30.00 ha,
-me p.rr. "Arbëria 3" .....	84.00 ha,
-me p.rr. "Qendra -Ulpiane" në Prishtinë .....	3.10 ha,

Gjithsej sipërfaqe e mbuluar me plane rregulluese .....**633.50 ha.**

#### Vështirësitë dhe përfitimet

Vështirësitë kryesore gjatë hartimit të planeve rregulluese do të mund të përmbledheshin si vijon.

Mungesa e shënimeve të nevojshme si:

- shënimet kadastrale – bazave gjeodezike,
- shënimet për infrastrukturën si: rrjeti i ujësjellësit, kanalizimit, elektrikës etj.,

- shënime për gjendjen faktike, gjegjësisht numri i madh i objekteve të ndërtuara pa leje ndërtimi,
- mospërputhja e gjendjes faktike nga aspekti pronësor me gjendjen kadastrale, me shënime pronësore që posedon Komuna, të cilat janë pasojë e mosbartjes së evidencave gjatë shit-blerjes së tokave, por edhe të ndërrimeve të bëra në mënyrë ilegale. Përfitimet nga hartimi i këtyre planeve rregulluese, si drejtorat, përveç planifikimit si detyrë e këtij drejtorati janë edhe :
  - përvoja e re, pasi është hera e parë e hartimit të këtij lloji të planifikimit,
  - përfitimet nga mënyra e punës së përbashkët përmes punëtorive me hartuesit e p.rregulluese,
  - përfitimet nga shkëmbimi i përvojave me hartues të cilët ishin nga vendet e ndryshme, (vëndor, nga Gjermania, Britania e Madhe dhe Sllovenia).

### **Caktimi i lokacioneve**

Gjatë kësaj peridhe raportuese këtij Drejtorati i janë paraqitur kërkesa për caktimin e lokacioneve për realizimin e programeve komunale dhe programeve tjera për ndërtimin e objekteve të interesit të përgjithshëm. Me qëllim të zgjidhjes së këtyre kërkesave, ky drejtorat ka hulumtuar dhe përcaktuar lokacione adekuate, duke kryer incizimet në terren. Janë konsultuar planet ekzistuese urbanistike dhe organet ekzekutive kompetente të Komunës lidhur me statusin pronësor-juridik të atyre lokacioneve. Janë përgatitur prezentimet grafike, në bazë të të cilave janë përgatitur propozimvendimet me arsyetimet përkatëse, të cilat janë prezentuar për shqyrtim në Bordin e drejtorëve , Komitetin për Planifikim , Komitetin për Politikë dhe Financa, si dhe në Kuvendin e Komunës.

### **Lokacionet e përcaktuara gjatë periudhës raportuese:**

- për ndërtimin e objektit të stacionit të pompave shtytëse në fshatin Bërnice e Poshtme,
- për ndërtimin e objektit të Qendrës Administrative Protokolare të Kuvendit të Kosovës në kompleksin e Gërmisë në Prishtinë,
- për Qendrën e Mjekësisë Familjare në fshatin Shkabaj,
- për ndërtimin e objektit të Qendrës Rajonale për Aftësimin Profesional në lagjen “Kalabria” në Prishtinë,
- për ndryshimin e lokacionit të Qendrës Kardio-kirurgjike,
- për vendosjen e bustit të “Henry Dunanit”.

Për lokacionet e caktuara për ndërtimin e objekteve për të cilat ka qenë investitor Komuna, janë përgatitur materialet, detyrat dhe programet projektuese për hapjen e tendereve, është marrë pjesë në komisionet për vlerësimin e dokumentacionit të ofertave, si dhe është bërë menaxhimi i realizimit – ndërtimit të këtyre objekteve nga personeli civil profesional i këtij drejtorati.

### **Përgatitja e materialeve, detyrave dhe programeve projektuese për hapjen e tendereve**

Përveç tendereve për planet rregulluese, gjatë periudhës raportuese gjithashtu janë përgatitur materialet, detyrat dhe programet projektuese për hapjen e tendereve, si dhe pjesëmarrje në komisione për vlerësimin e tyre, nga përgjegjësjja e këtij drejtorati, si p.sh. për:

- zgjidhjen ideore të tipit të qoshqeve për qytetin e Prishtinës ,
- zgjidhjen e projektit ideor për ndërtimin e ob. të shkollës fillore në fshatin Llukar,
- zgjidhjen e projektit ideor për nd. e ob. të shkollës fillore në lagjen “Vreshtat”,

- zgjidhjen e projektit ideor urbo-arkitektonik për ndërtimin e ob. të “Qendrës së Mjekësisë Familjare” në lagjen “Kodra e Trimave” në Prishtinë,
- zgjedhjen e projektit ideor urbo-arkitektonik për ndërtimin e “Qendrës së Mjekësisë Familjare” në lagjen Kalabria në Prishtinë,
- detyrat projektuese-përshkrimi teknik i ulëseve për tribunat e Stadiumit të Prishtinës,
- zgjedhjen e projektit ideor të objektit të parking- garazheve në Prishtinë,
- përgatitjen e materialit tenderues për revidimin e projektit të parking-garazheve në Prishtinë,
- përgatitjen e materialit tenderues për kontrollimin teknik të objektit banesor në l. “Bregu i Diellit” në Prishtinë.

## II. SEKTORI I URBANIZMIT

### ZGJIDHJA E KËRKESAVE TË PERSONAVE FIZIKË DHE JURIDIKË

Gjatë periudhës raportuese, këtij drejtorati i kanë arritur 933 kërkesa, ndërsa të bartura nga viti paraprak kanë qenë 34 kërkesa, që do të thotë se, gjatë këtij viti raportues kanë qenë për shqyrtim 967 kërkesa, zgjidhja e të cilave bie në përgjegjësinë e këtij drejtorati.

Kërkuesit kanë qenë persona fizikë dhe juridikë.

Përmbajtja e kërkesave ka qenë kryesisht: caktimi i lokacioneve, lëshimi i lejeve urbanistike për caktimi e kushteve urbanistiko-teknike, lejeve ndërtimore, vendosja e objekteve të përkohëshme, informacione për destinimet e sipërfaqeve në planet përkatëse urbanistike, caktimi i dispozitave sipas planeve detale, për rrënimin e objekteve ekzistuese, lëshimin e vërtetimeve për dëme të shkaktuara nga lufta, për ndërrimin e destinimit të përdorimit të objekteve ekzistuese, legalizimin e ndërtimeve pa leje, kërkesa për informacione tjera mbi kushtet për rregullimin e hapësirës, si dhe kërkesa dhe kundërshtime me përmbajtje të ngjashme.

Vendosja e kërkesave në shumicën e rasteve është bërë në bazë të konkluzioneve përfundimtare ndërsa, për një pjesë të tyre nuk ka qenë e nevojshme të nxirret konkluzion përfundimtar por të njëjtat janë vendosur në bazë të informacioneve, përgjegjëjeve apo lëshimit të vërtetimeve të kërkuara.

Paraqitja e kërkesave të arritura, dhe të atyre të bartura nga viti paraprak, si dhe mënyra e zgjidhjes së tyre, dhe atyre në procedurë, në mënyrë tabelare duket si më poshtë:

1	2	3	4	5
Të arritura gjatë periudhës raportuese	Të bartura nga periudha paraprake (2004)	Gjithsej për punë gjatë vitit raportues	Të zgjidhura	Në procedurë
933	34	967	817	116

**Mënyra e vendosjes sipas kërkesave të paraqitura në tabelën e sipërme duket si më poshtë:**

	nr.i kerkes.	miratuara	refuzime	informime	Projek. Ideor.	konkluzua	pëlqime	procedur.
Leje urbanistike.	436	99	102	126	59	3	27	20
		miratuara				kompenzimi		
Leje ndertimore.	118	98	8	12		307.875,35€		



## **a) Mënyra e vendosjes sipas kërkesave**

Zgjidhja e kërkesave është bërë në bazë të konkluzioneve përfundimtare-aktvendimeve, pëlqimeve, përgjigjeve dhe vërtetimeve, si dhe në bazë të përgatitjes së propozimvendimeve për Kuvendin e Komunës.

Vendosja sipas kërkesave për lëshimin e lejeve urbanistike, me të cilat caktohen kushtet urbanistike-teknike dhe lejimi i ndërtimeve, është bërë sipas planeve përkatëse urbanistike dhe në formë të rikonstruimit të objekteve ekzistuese me zgjerime minimale, nga shkak se, në shumicën e rasteve, hapësirat ku është kërkuar lejimi i ndërtimit, në bazë të Planit strategjik- zhvillimi urban i Prishtinës, kanë pasur destinimin e banimit por, për këto hapësira, në momentin e vendosjes së kërkesave kanë munguar planet rregulluese.

Pas miratimit të planeve rregulluese për disa lagje të qytetit, kjo kategori e kërkesave është vendos sipas destinimeve dhe përmbajtjeve të planifikuara me këto plane, me lëshimin e lejeve urbanistike dhe në formën e kushteve për zgjedhjen e projektit ideor të blloqeve urbane brenda kufijve të planeve rregulluese. Vendosja e kërkesave për lejimin e ndërrimit të destinimit të sipërfaqëve banesore në hapësira afariste, si dhe kërkesave për përligjjen e këtyre veprimeve, është bërë në bazë të kritereve të përcaktuara me Vendimin e Kuvendit të Komunës nr. 01-35-2425. të dt. 10.09.2004.

## **Arsyet kryesore për refuzimin e kërkesave**

Gjatë shqyrtimit të kërkesave, arsye kryesore për nxjerrjen e konkluzionit për refuzimin e tyre ka qenë:

- çështja pronësorë-juridike e pazgjidhur në tokën apo hapësirën ku është kërkuar lejimi i ndërtimit,
- ngase sipërfaqet në të cilat është kërkuar lejimi i ndërtimit, sipas PU kanë pasur destinim tjetër nga ai i kërkuari, si dhe nga arsyeja e qasjes së programeve komunale për nxjerrjen e planeve rregulluese, përkatësisht mungesa e këtij niveli të planeve,
- ngase kërkesat për lejimin e ndërtimeve jashtë kufijve të fshatrave, përkatësisht në tokën bujqësore ose në afërsi të rrugëve magjistrale, hekurudhore dhe rrugëve tjera,
- ngase kërkesat për lejimin e ndërrimit të destinimit të hapësirave në objektet banesore (kolektive), për të cilat nuk është argumentuar e drejta pronësore e kërkuarve në ato hapësira, si dhe atyre të cilave nuk ka mundur t'iu ndërrohet destinimi pa ndërhyrje me punë ndërtimore në konstruksion të objektit si tërësi, dhe pamundësisë së shfrytëzimit të qasjeve ekzistuese, si dhe ndikimet negative në stabilitetin dhe aspektin urban të objektit në tërësi,
- kërkesa për vendosjen e objekteve të përkohshme në sipërfaqe publike pa provën mbi të drejtën e shfrytëzimit të asaj sipërfaqeje.

Dukuri e shpeshtë e cila ka ndikuar në marrjen e konkluzionit për refuzimin e kërkesave, ka qenë se, kërkesat për lëshimin e lejeve urbanistike, për caktimin e kushteve urbanistike-teknike dhe për lejimin e ndërtimit, janë paraqitë pas përfundimit të zhvillimit të punimeve ndërtimore, apo pas kryerjes së punëve të konsiderueshme, gjë që është konstatuar gjatë shqyrtimit të kërkesave e në procedurën e daljes në vendëshikim. Bazuar në këtë, ky drejtorat, konform me rregullativën ligjore në fuqi, këto kërkesa i ka refuzuar me arsyetimin se, janë zhvilluar punimet ndërtimore pa u caktuar kushtet urbanistike-teknike dhe pa u lejuar ndërtimi.

## **Kërkesat e aprovuara dhe ato në procedurë**

Në numërin e kërkesave të paraqitura si të miratuara, është paraqitur numri i lejeve urbanistike mbi caktimin e kushteve urbanistiko-teknike, lejet ndërtimore, pëlqimet me të cilat është lejuar zhvillimi i punimeve ndërtimore, të cilat nuk kanë ndryshuar projektin e objektit ekzistues, përkatësisht punët të cilat, komform me rregullativën ligjore, nuk janë trajtuar ndërtim dhe as rikonstruim, si dhe konkluzionet tjera me të cilat është zgjidhur çështja pa qenë e domosdoshme të nxirret vendim i veçantë, e të cilat janë zgjidhur në të mirë të kërkuësve, propozimvendimet e miratuara nga Kuvendi për caktimin e lokacionit, lëshimi i vërtetimeve mbi shkallën e dëmtimit nga pasojat e luftës, si dhe kërkesat tjera të ngjashme në favor të palëve.

Në numrin e lëndëve të paraqitura në procedurë, pos lëndëve për të cilat është kërkuar plotësimi i tyre, janë edhe ato të cilat kanë arritur në gjysmën e dytë të muajit dhjetor të vitit raportues.

### **Vendosja sipas kërkesave për pranimin teknik të objekteve dhe lejimi i tyre për përdorim dhe shfrytëzim**

Meqenëse pas përfundimit të ndërtimit, konform me rregullativën ligjore në fuqi, investitori është i obliguar që të pajiset me leje përdorimi dhe shfrytëzimi, e cila leje mund të lëshohet vetëm pas kontrollimit teknik nga komisioni profesional i formuar nga organi që ka lëshuar lejen për ndërtim, gjatë kësaj periudhe këtij drejtorati i janë paraqitur 4 kërkesa për caktimin e komisionit profesional për kontrollim teknik të objekteve të përfunduara së ndërtuari.

Duke shqyrtuar këto kërkesa, ky drejtorat ka caktuar komisionin përkatës për 4 raste .

### **Dhënia e informacioneve dhe vlersimi i dëmeve nga pasojat e luftës për objektet e dëmtuara nga lufta**

Gjatë vitit raportues, ky drejtorat ka caktuar komisionet përkatëse për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në objektet nga pasojat e luftës për 4 raste, sipas kërkesave të palëve. Pasi që tërë dokumentacioni mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara udhëhiqet në këtë drejtorat, gjatë këtij viti janë dhënë shumë informacione dhe shënime sipas kërkesave të bashkësive locale, si dhe organizatave tjera joqeveritare ndërkombëtare dhe organizatave tjera.

Po ashtu, gjatë vitit raportues janë lëshuar 39 vërtetime mbi shkallën e dëmtimit të pësuar nga lufta, sipas kërkesave të personave civilë dhe juridikë.

### **III. SEKTORI I NDËRTIMIT**

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë kryer këto punë:

- detyrat projektuese për infrastrukturë,
- mbikëqyrja e objekteve përndërtimin e të cilave investues ka qenë Komuna,
- marrja pjesë në pranimet teknike të objekteve dhe punimeve të kryera,
- marrja pjesë në komisionet për vlerësimin e tendereve,
- përgjigjja në lëndët që kanë të bëjnë me infrastrukturë dhe rindërtim.

#### **Detyrat projektuese të infrastrukturës Rrugët e qytetit**

Janë vizituar dhe fotografuar rrugët, të cilat si prioritet për ndërtim i ka caktuar Drejtorati i Shërbimeve Publike, Transportit dhe i Mbrojtjes së Ambientit. Janë përgatitur detyrat projektuese dhe janë përcjellë punimi i projekteve për rrugët : “Malush Kosova”, “Shaban Shala”, “Kukësi”, “Agron Rrahmani” dhe “Aziz Zhilivoda”.

#### **Mbikëqyrja e objekteve për të cilat investues ishte Kuvendi i Komunës:**

## **Pjesëmarrja në pranimet teknike të objekteve dhe punimeve të kryera:**

- Ujësjiellësi në Prugovc,
- Ujësjiellësi në Llukar,
- Kanalizimi në Hajvali,
- Kanalizimi në rrugën “Llapi”,
- Ndërtimi i rrugës “Haxhi Zeka”,
- Ndërtimi i rrugës “ Caraleva”,
- Ndërtimi i terrenit sportiv në Gërmi,
- Sanimi i kanalizimit në lagjen “Kodra e Diellit”,
- Objektin e logjistikës së SHPK-së,
- Objektin e ministrive ,
- Vendosja e ulëseve në Stadiumin e Qytetit.

## **Pjesëmarrja në komisionet për vlerësimet e tenderëve**

Duhet theksojmë se nga ky drejtorat çdo herë ka marrë pjesë një ose dy anëtarë në vlerësimin e tendereve të organizuar nga Zyra e prokurimit të Komunës.

Po i cekim disa më të rëndësishme:

- vlerësimi i tenderit për ndërtimin e kompleksit në lagjen “Kodëra e Diellit”,
- vlerësimi i tenderit për zgjedhjen e projektuesit për projektimin e Ulpianës.
- Vlerësimi i tenderit për dhënien me koncesion të ndërtimit të garazheve publike,
- Vlerësimi i tenderit për zgjedhjen e projektuesit për objektin e Shkollës fillore në fashatin Llukar dhe të asaj në lagjen “Vreshtat” etj..

## **Përgjigjja e lëndëve që kanë të bëjnë me infrastrukturë dhe rindërtim**

Gjatë këtij viti raportues u është dhënë përgjigje kërkesave që kishin të bënin me infrastrukturë, si: pëlqime urbanistike, detyra projektuese etj..

- Informime dhe vërtetime për rikonstruim të objekteve :
  - a) vërtetime 48
  - b) informime 6

## **Punët tjera nga përgjegjësia e Drejtoratit:**

- Qendra e Mjekësisë Familjare në Kalabri ,
- Qendra e Mjekësisë Familjare në lagjen “Kodrën e Trimave”,
- Çerdhja e Fëmijëve në Graçanicë,
- Ndërtimi i kompleksit të banesave në lagjen “Kodra e Diellit”,
- Ndërtimi i urës në Keqekollë,
- Ndërtimi i Ambulancës në Llukar,
- Ndërtimi i obj. të Bashkësisë lokale në Hajvali,
- Vendosja e ulëseve në Stadiumin e Prishtinës,
- Asfaltimi i rrugës për fshatin Barilevë dhe shtruarja e rrugës për Bërnice,
- Ndërtimi i ujësjellësit në Sofali,
- Ndërtimi i kanalizimit në Mat,
- Ndërtimi i kanalizimit në Besi dhe Trudë,
- Ndërtimi i kanalizimit në Graçanicë dhe Qagllavicë,
- Ndërtimi i kanalizimit në Shkabaj,
- Renovimi i Bibliotekës në Shkabaj,
- Ndërtimi i terreneve sportive në Hajvali dhe Gërmi.

Gjatë periudhës raportuese, pas miratimit të planeve rregulluese për zonat përkatëse të përmendura në këtë raport, është paraqitur nevoja e rishqyrtimit të lartësisë së kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore, kështu që janë kalkuluar çmimet përkatëse për ndërtimin e infrastrukturës të interesit të përgjithshëm shoqëror në kuadër të këtyre planeve, në mënyrë që të gjendet vlera reale e pagesës së këtij lloji kompensimi. Andaj, drejtorja ka përgatitur propozimvendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores mbi tarifatat dhe ngarkesat komunale, i cili është miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës, 01-413-575, të dt. 22.11.2005.

Po ashtu, gjatë vitit raportues është punuar në harmonizimin e formës së konkluzioneve përfundimtare për zgjidhjen e kërkesave me rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit dhe i ndërtimit, si dhe aktet tjera nënligjore të këtyre ligjeve e të nxjerra gjatë vitit raportues.

Është e rëndësishme së veçantë të përkthehet puna e këtij drejtorati në informacionet e përditshme gojore lidhur me destinimet e planifikuara me Planin strategjik-zhvillimi urban i Prishtinës dhe planeve rregulluese të nxjerra në bazë të tij.

## **PROPOZIMI I MASAVE**

- Që me një akt të veçantë të bëhet ndarja e kompetencave në mes të drejtorateve në mënyrë decisive, sepse me Statut dhe Rregulloren për organizimin e brendshëm të organeve ekzekutive të Komunës, këto kompetenca janë dukshëm të ngatërruara;
- Të intensifikohet bashkëpunimi ndërmjet drejtorive të Komunës për çdo iniciativë të projekteve urbaniste në kuadër të përgjegjësisë së secilës drejtori, deri në realizimin e projekteve;
- Të rritet (shtohet) numri i personelit civil profesional nëpër rejtori, e veçanërisht ai nga lëmi i arkitekturës.

## **IX. DREJTORATI I INSPEKSIONIT**

Drejtoria i Inspeksionit ka ushtruar mbikëqyrje përkitazi me zbatimin e ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe rregulloreve të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Në vazhdim do të paraqesim përshkrimin e detajizuar të specifikave dhe detyrave për çdo sektor, veç e veç, në mënyrë tabelare, bazuar në planprogramet e punës për periudhën janar-dhjetor 2005, si vijon:

<u>Punët e kryera</u>	<u>Spektori i inspeks. të tregut</u>	<u>Spektori i inspeksionit sanitar-vet.</u>	<u>Spektori i inspek.komu. të komunikacionit</u>	<u>Spektori i inspek.të ndërtimit</u>	<u>Spektori bujq.m broj.</u>	<u>Gjithsej</u>
Kontrollime	6434	2111	12780	1530	1794	24.649
Procesverbale	3505	949	3886	1530	1534	11.404
Aktvendime	42	161	733	115	210	1.261
Fletëparqitje	341	234	1834	/	/	2.409
a)Gjykatës për Kundërvajtje	338	229	142- komunal 1692- trafik	/	27	2.428
b).Gjykatës Ekonomike	03	05	/	/	/	08
Lëndë të vl.pozitivisht	60	186	895	/	05	1.146
Lëndë të refuzuara	04	26	233	/	03	260
Lëndë në proced.gjyqësor	273	17	799	/	19	1.108
Vlera e denimeve nga Gjyk.për Kundërvajtje	12.850	34.850	47.366-Trafik	/	1.950	96.516 . €
Pëlqime për kushte minimale teknike	Komisioni i përbashkët i Inspeksionit të tregut, sanitar dhe komunal					781
Gjithsej mjete te planifikuara nga pëlqimet sanitare	Komision i përbashkët					104.223 €
Mjetet të pa inkasuara nga pëlqimet tekniko - sanitare	Komision i përbashkët					8.331 €
Mjete të inkasuara nga pëlqimet tekniko-sanitare						95.893.
Largime të garazhave pa leje				32		32
Largime të qoshqeve pa leje dhe objek.montuese			624 qoshqe 11.obj.montuese			635
Largim dhe rrënim të objekteve të ndryshme				210		210
Rekomandime sanitare		778				778
Mostra të ushqimit Mostra të ujit	/	386 230	/	/	/	386 230

<b>Mostrat e kripës</b>		59				59
<b>Mallra të asgjësuar dhe të konfiskuara</b>	23.550 .€	1.166. 092.00 €	/	/	858.200€	2.047.842 ,00.€
<b>Urdhëresa me shkrim</b>	424	/	/	423	/	447
<b>Kontrollime të kafsheve për therje, dhe vulosja e mishit të frekët</b>	/	4554	/	/	/	4.554
<b>Njoftim palëve</b>	/	/	733	/	/	733
<b>Aksione te përbashkëta me SHKP-në per largim të shitësve ambulantë</b>		/	/	/	/	26
<b>Strisha nga sipërfaqet punuese</b>		491				491

## **I. Sektori i inspeksionit të tregut**

Gjatë periudhës raportuese Sektori i inspeksionit të tregut është angazhuar për realizimin e punëve dhe detyrave të planifikuara sipas planit vjetor të punës , dhe atë :

- në mbikëqyrjen inspektuese të subjekteve afariste – bizneseve , lidhur me regjistrimin e tyre , marrjen e pëlqimeve nga Inspeksioni për plotësimin e kushteve minimale-teknike, sanitare, higjienike, kushteve të mbrojtjes në punë dhe të mbrojtjes së ambientit dhe të posedimit të lejes së punës,
- në kontrollimin e shitjes së palejuar nga subjektet afariste dhe qytetarët , nëpër rrugë, sheshe publike dhe gjelbëruese , trotuare e gjetiu pa lejen e punës nga organi kompetent i Komunës,
- në resepektimin për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës nga lëmi i tregtisë , hotelierisë, zejtarisë dhe i shërbimeve tjera në territorin e komunës së Prishtinës,
- në pranimin , shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave të qytetarve,
- në kryerjen e detyrave sipas urdhërit të drejtorit të Drejtoratit nga kompetencat e këti shërbimi-sektori.

## **II. Sektori i inspeksionit sanitar dhe veterinar**

### **a). Inspeksioni sanitar**

Aktiviteti i këtij sektori përfshinë :

- kontrollimin e artikujve jetësor dhe mjeteve të përdorimit të përgjithëshëm,
- kontrollimin e ujit të pijshëm ,

- kontrollimet sipas kërkesave të palëve – detyrë e përhershme ,
- kontrollimet higjieno-sanitare e objekteve publike ( hoteleve, marketeve, shitoreve, restoranteve , bufeve etj, me destinim të njëjtë ),
- vizitat në objektet shkollore ( kushtet higjieno-sanitare ) ,
- kontrollimin e objekteve publike që merren me prodhimin dhe qarkullimin e artikujve jetësor , marrja e masave për verifikim të rregullsisë së tyre,
- kontrollimin e qoshqeve ( hamburger-qebatore, ëmbëltove, për kushtet higjieno-sanitare dhe marrja e masave për verifikim të prodhimeve të tyre,
- kontrollimin e farmacive dhe prodhimeve farmaceutike në territorin e komunës së Prishtinës.

### **b). Inspeksioni i veterinarisë .**

Veprimtaria brenda këtij sektori gjate periudhës raportuese, ka qenë i orientuar në:

- përgatitjen e planëprogramit për vaksinimin e bagëtive dhe të qenve në territorin e komunës së Prishtinës ,
- mbikëqyrjen e përhershme të mishtoreve , NTP-ve, DPT-ve, restoranteve, hoteleve etj., ku shiten gjërat ushqimore me prejardhje shtazore,
- kontrollin e përhershëm të qumështoreve dhe prodhimet e tyre ,
- bënë kontrollin higjieno-veterinar të kafshëve , para , gjatë dhe pas therjes në thertore , bënë shikimin veterinar të mishit, vulosjen e tij me vulën e Inspeksionit sanitar në mishtore,
- bënë kontrollin e barnatore veterinare,
- mbikëqyr dhe inspekton gjërat ushqimore me origjinë shtazore gjatë prodhimit dhe qarkullimit.

### **III. Sektori i inspeksionit komunal dhe i komunikacionit**

Aktiviteti i punës së këtij sekori është i bazuar kryesishtë në këto veprimtari :

- kontrollimi i rrugëve dhe trotuarve për pastrim nga bora dhe nga hedhurinat e ndryshme , largimin e shitësve nga trotaret dhe sipërfaqet tjera publike, në bashkëpunim me inspektorët e tregut , Shërbimin Policor të Kosovës dhe UNMIK-un ,
- mbikëqyrja dhe zbatimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbi kontrollimin e trafikut urban e publik, largimin e autotrasportuesve dhe kamionëve me material ndërtimor ( me rërë) nga rrugët dhe sipërfaqet publike ,
- kontrollimi i mirëmbajtjes së sipërfaqes publike , të gjelbruara , si p.sh. parku i Gërmisë , parqet tjera të qytetit , kontrollimi i autoparkingjeve , si dhe bashkëpunimi me NPK “Hortikukultura” .
- kontrollimi i ndërmarrjeve publike siç janë “Higjieno Teknika” , “Batllava” etj, mbi mënyrën e kryerjes së shërbimeve të tyre ndaj qytetarëve ,
- kontrollimi i objekteve publike, siç janë stacionet , sheshet, si dhe objektet e përkohshme lëvizëse , panotë, reklamat, firmat ndriçuese , mbishkrimet e objekteve afariste zejatre etj.,
- kontrollimi i vendosjes së tavolinave e karrigeve para objekteve hoteliere , eksponimi i mallrave para lokaleve tregtare , së bashku me Drejtoratin e Pronës,
- kontrollimi mbi zbatimin e Rregullorës mbi kufizimin e përdorimit të ujit të pijshëm në mënyrë të padestinuuar , si dhe Rregullores për zhurmë ,
- kontrollimi i ndërmarrjeve publike shërbyese, si Stacionin e autobusëve ( për orarin e nisjes dhe arrijtes së autobusëve në linjat urbane e ndërurbane ),
- kontrollimi i rregullt i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit për ujërat fekale dhe atmosferike,



- përgjigjja në kërkesat e palëve rreth paraqitjës së prishjeve të ndryshme të objekteve të infrastructures,
- kontrollimi i qoshqeve rreth marrjes së masave ndaj vendosjes së tyre pa leje nga organi kompetent komunal,
- aksionet e përbashkëta me inspektorët e tregut, sanitarë etj., për eliminimin e dukurive negative të paraqitura në qytet e rrethinë.

Bazuar në detyrat e parapara me planin e punës për periudhën janar – dhjetor 2005, ky sektor ka kryer këto punë:

Gjithsej kërkesa të palëve të pranuar	296
Kontrollime	12780
Procesverbale	3886
Aktvendime	733

Fletëparaqitje në Gjyk. për Kundërvajtje	142
Fletëparaqitje në Gjyk. Për Kundërv., për trafik	1692
Njoftime me shkirm ndaj kërkesave të palëve	296
Ankesa ndaj aktvendimve të inspektorëve	69
Kthimi i ankesave nga shkalla e dytë	68

Largim i qoshqeve	624
-------------------	-----

Largimi i objekteve montuese	11
Aksioni me Inspksionin e komunikacionit dhe SHPK-në për kontrollimin e kombibusëve	12

Aksioni me Inspeksionin e tregut dhe SHPK-në për largimin e stërshitësve	26
Aksioni me DSHP-D,Finanacave për evidencimin e tavolinave	1
Aksioni me KUR"Prishtina " dhe SHPK-në për autolarje	1
Aksioni me NPK "Pastrimi" për largimin e mbeturinave nga sip.publike	4
Aksioni me Insp.e tregut dhe SHPK-në për largimin e shitësve të rërës.	8
Aksioni me Inspeksionin e tregut dhe SHPK-në për asgjësimin e mjeteve piroteknike	2
Komis. i përbashkët me Insp.e tregut dhe ins. sanitar , për pranimin e lok.afariste	781
Inkasimi I mjeteve nga aksioni i përbashkët me DSHP-në dhe Financa komunale	53.590. €

Gjatë kësaj periudhe janë bërë mbi 1530 kontrollime në tërë qytetin dhe rrethinën e tij: Janë inspektuar mbi 539 objekte, prej të cilave dhe janë lëshuar 115 aktvendime . Numri tjetër i mbetur nga numri i përgjithshëm i i inspektimeve janë urdhërndalesa për ndërprerjen e punimeve, si dhe një numër i vogël me procesverbal. Në territorin e komunës së Prishtinës, gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur raste kur kemi bërë rrethimin e objekteve , por nuk kemi as raste që kemi dërguar në gjykatë për procedurë gjyqësore , që do të thotë as kthim të lëndëve nga ana tjetër. Po ashtu, ky sektor ka intervenuar sipas kërkesave të palëve ( të cilat iu kanë drejtuar këtij sektori

për intervenim ). Inspeksioni ka intervenuar në 225 raste, në bazë të kërkesave të qytetarëve .

Problematikë tjetër e cila e ngakon punën e Inspeksionit, është edhe shndërrimi i banesave , garazheve , bodrumeve në lokale afariste, ca prej tyre me dokumentacion teknik dhe leje shndërrimi, kurse të tjerat pa leje. Dukuri tjetër që është paraqitur edhe në këtë periudhë është ajo e mbindërtimeve, të cilat po ashtu ndërtohen pa kurrfarë dokumentacioni teknik .

Për parandalimin e të gjitha këtyre dukurive negative, Inspeksioni i ndërtimit ka qenë shumë aktiv, gjë që tregon edhe numri i objekteve të rrënuara ( mbindërtime 8 , shtojca 30 , konstruksione të drurit 5 , themele 15 , objekte banimi 15 , gropim të terrenit 5 , tarraca 12, garazhe 35 , shkallë 13 , rrëtime të katit 10 , shtylla të katit 6, rrëtime të mbulesës – kulmit 5, rethoja 25, pllaka 6, lokale afariste 20 , mure 15 ), gjithsej 242 raste. Në mungesë të ekskavatorit për rrënimin e objekteve të larta, kemi qenë të kufizuar në këtë drejtim, gjë që është vlerësuar edhe nga stafi i Kuvendit, prandaj është marrë qëndrimi nga ana e tyre të hapet tenderi për rrënimin e objekteve të larta dhe ka rezultuar me rrënimin e objektit në rr. “ Luan Haradinaj” .

Në numrin e përgjithshëm të objekteve të rrënuara gjatë këtij viti, janë përfshirë edhe disa aktvendime për rrënim të objekteve të vitit të kaluar.

Ky sektor tani është në përgatitje të përpilimit të planit për vitin e ardhshëm, ku sigurisht do të përqendrohemi në rrënimin e objekteve të larta, si dhe objekteve të ndërtuara në pronën shoqërore. Po ashtu, do të fokusohemi në mbrojtjen e lagjeve për të cilat veç janë miratuar planet rregulluese urbanistike. Me të dhënat të cilat janë cekur më lart, paraqitëm punën e bërë dhe kryerjen e detyrave tona gjatë periudhës janar-dhjetor.

## **V. Sektori i inspeksionit të bujqësisë dhe të mbrojtjes së ambientit**

### **a). Inspeksioni i mbrojtjes së ambientit jetësor .**

Ky sektor kryen këto shërbime:

- kontrollon menaxhimin e deponive për hudhjen e mbeturinave ,
- kontrollon mbrojtjen e ambientit nga dëmtimet e ndryshme, qoftë nga personat e papërgjegjshëm apo nga bota shtazore.

### **b). Inspeksioni i bujqësisë.**

Ky sektor i lëmit të inspektimit kryen këto shërbime:

- përcjell dhe mbikëqyr ndërmarrjet ( kooperativat bujqësore , masat agroteknike ),
- bënë kontrollimet e jashtëzakonshme, sipas kërkesave të palëve lidhur me ankesat dhe parashtrirat e tyre,
- bënë kontrolloimin e përqindjes së pijeve alkoolike dhe joalkoolike në qarkullim ( nëpër lokalet që merren me shitjen e tyre ,
- bënë mbikëqyrjen e artikujve ushqimor me prejardhje bimore, prodhimin, qarkullimin dhe afatin e përdorimit ,
- bënë kontrollimin e tregjeve ( ku shiten fidanet e pemëve, farërat e ndryshme etj),
- kontrollon barnatoret bujqësore,
- kontrollon masat agro-teknike , lavrimin dhe kushtet e kërkuara për të,
- bënë kontrollimin rreth mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore, si dhe kontrollon korrjet shirjet gjatë sezonës .

Nga ky sektor, gjatë periudhës raportuese janë kryer këto veprimtari :

-Kontrollime .....	1794
-Procesverbale .....	1534
-Aktvendime.....	210
-Fletëparaqitje në Gjykatën për Kundërvajtje .....	27
-Të realizuara .....	05
-Të refuzuara.....	03
-Në procedurë.....	19
-Vlera e fletëparaqitjeve të realizuara .....	950
-Asgjësimit i mallit pa afat, 68.475 litra dhe 31.992 kg.....në vlerë prej .	858.200 .€

*Në aktivitetin e përgjithshëm të Drejtoratit, përveç punëve të parapara në planprogram, janë përfshirë edhe një varg aktivitetësh tjera me rëndësi për këtë drejtorat, që tani do t'i japim paksa më të detajizuara në kuadër të të gjitha sektorëve.*

- Aksioni i përbashkët i Inspeksionit me SHPK-në për largimin e stërshitësve ambulantë nga trotuaret dhe rrugët e qytetit , në veçanti para Tregut në Ulpianë dhe në pjesën e vjetër të qytetit, me ç'rast disa here është bërë edhe konfiskimi i mallrave të ekspozuar.
- Punëtorët e sektorëve të tjerë janë angazhaur kryesishtë në realizimin e punëve përkatëse sipas planit dhe sipas rasteve .
- **Inspektorët e tregut** - kanë kontrolluar subjektet afariste për respektimin e ligjshmërisë, siç janë : leja e punës dhe dokumentacioni përkatës .
- Sektori sanitar ka bërë kontrollimin e objekteve hoteliere , kuzhinave publike , mishtoreve , pishinave dhe objekteve shkollore për kushtet higjienike .
- **Sektori i bujqësisë** - kryesisht ka bërë përcjelljen e fushatës së korrjeve-shirjeve , mbikëqyrjen e masave agroteknike, si në sektorin shoqëror, ashtu edhe në atë privat, barnatoret bujqësore, furrat private për kualitetin e bukës , prodhimet dhe finalizimet, mbikëqyrjen e artikujve ushqimor me prejardhje bimore, si dhe pijet alkoolike dhe joalkoolike, prodhimin qarkullimin , afatin dhe kualitetin e tyre.
- **Sektori i ndërtimit** - ka vazhduar me punën e përditshme në parandalimin e ndërtimeve pa leje dhe ushtrimin e masave administrative ndaj tyre .
- **Sektori komunal** dhe **Sektori i komunikacionit** – kanë qenë të angazhuar kryesishtë në zbatimin e planit të punës në kuadër të kompetencave përkatëse rreth zbatimit të ligjshmërisë dhe pengimit të dukurive negative të hasura në terren. Me ritëm të vazhduar ka bërë kontrollimin e subjekteve afariste për ekspozimin e mallrave jashtë lokaleve shitëse dhe ka ndërmarrë masa të duhura ligjore ndaj tyre. Ky sektor, gjegjësishtë inspektorët e komunikacionit, në bashkëpunim me SHPK-në- policinë e trafikut, kanë kontrolluar autotaxit dhe kombibusët , për respektimin e rregullave dhe të linjëve përkatëse, si dhe janë ndërmarrë masat e duhura ligjore ndaj kundërvajtësve . Ky sektor si aksion të vacantë dhe mjaftë të sukseshëm, gjatë periudhës raportuese pati largimin e të gjitha qoshqeve nga hapësira publike në tërë qytetin .
- Me ndërmarrjet shërbyese dhe komunale Drejtorati i Inspeksionit pati një bashkëpunim të mirëfilltë dhe bashkërishtë u zgjodhën shumë probleme të paraqitura në terren .

- Drejtorati për punë të Inspeksionit të KK të Prishtinës, si gjithëherë më parë edhe gjatë periudhës raportuese pati një bashkëpunim të sigurtë dhe mjaft të suksesshëm me SHPK-në në realizimin e detyrave të përbashkëta .
- Drejtorati i Inspeksionit edhe ditëve të vikendit ka caktuar kujdestari të rregullt për pengimin e dukurive negative të hasuara në terren , e që, për fat të keq, kjo punë nuk u është kompensuar si punë jashtë orarit punëtorëve të Inspeksionit .
- Këto dhe aktivitete tjera janë vetëm një pjesë e pasqyrit të punëve vuluminoze në këtë Drejtorat .
- Për të gjitha rastet e veçanta gjatë kontrollimit, si dhe masat ligjore të ndërmarra, mbahen shënime arkivore , siç janë: procesverbalet, aktvendimet, rekomandimet, përgjigjet palëve, e deri te procedura administrative gjyqësore .

Ky drejtorat gjatë aktivitetit për mirëvajtjen e procesit të punës ka zhvilluar kontakte dhe bashkëpunim të mirë me gjitha subjektet, si me drejtoritë brenda Komunës së Prishtinës, po ashtu edhe me drejtoritë e inspeksionit të komunave tjera të Kosovës, me Administratën e UNMIK-ut , Policinë e UNMIK-ut , Shërbimin Policor të Kosovës, ndërmarrjet publike shërbyese, Mediat Elektronike dhe të shkruara, e në veçanti bashkëpunim të mirë pati me bashkësitë lokale dhe me qytetarët në territorin e Prishtinës.

## X. DREJTORATI I ZHVILLIMIT RURAL

Prioritetet janë caktuar në harmoni me mjetet e ndara për Drejtoratin e Zhvillimit Rural, si dhe me bashkëpunim të vazhdueshëm me Komitetin për zhvillim rural.

### a. Sektori i zhvillimit rural

#### I. Projektet e realizuara:

Sektori i zhvillimit rural				
Nr.	Projektet	km	KK Prishtinë	Donatori
1.	Sanimi dhe mirëmbajta e rrugëve rurale të kat. IV	22	171 533.50 €	--
2.	Kanalizimi në fshatin Shkabaj	0,7	119 006.06 €	--
3.	Rregullimi i kanalit në fshatin Grashticë	0.10	36 178.80 €	--
4.	Ndërtimi i urës në fshatin Keqekollë		9 776.45 €	--
5.	Asfaltimi i rrugës Mramor-Busi		144 974.75 €	--
6.	Asfaltimi i rrugës Bernicë-Siqevë	4,0	220 771,25 €	--
7.	Asfaltimi i rrugës Besi-Prugofc-Barilevë	2,9	179 906.00 €	--
8.	Asfaltimi i rrugës në fshatin Shkabaj	2,9	118 530.50 €	--
9.	Asfaltimi i rrugës në fshatin Hajvali, pjesa e vjetër e rrugës	2,0	106 455.00 €	--
10.	Sanimi i gropave në rr.Grashticë-Mramor dhe pastr. i dheut rr. Keqekollë-Ballaban		7 762.50 €	--
11.	Kanalizimi fekale në fshatin Barilevë		25 642.35 €	--
12.	Rreg.i rrugës pranë sh.f. "Teuta" Grashticë		4 860.00 €	--
	<b>Gjithsej:</b>		1145 397.16 €	--

## **b). Sektori i bujqësisë**

Punët e kryera nga ky sektor gjatë periudhës raportuese:

1. Fushat eksperimentale për perimtari;
2. Furnizimi me llakto-friz për fermerët në Keqekollë;
3. Planprogrami për mbjelljet pranverore 2005;
4. Raporti mbi realizimin e planprogramit për mbjelljet pranverore 2005;
5. Raporti përfundimtar për dëmet e shkaktuara nga të reshurat;
6. Rrjedhat e punës në parkun regional “ Gërmia”.
7. Realizimi i Projektit: “ Pastrimi fito-sanitar i parkut regional “Gërmia”;
8. Përcjellja e projektit për mirëmbajtjen e gjelbërimit në parkun e qytetit dhe në Tauk-Bahqe për vitin 2005;
9. Përcjellja e punëve në procesin e korrje-shirjeve;
10. Planprogrami i mbjelljeve vjeshtore 2005;
11. Projekti i veterinës mobile;
12. Eliminimi i qenve endacakë;
13. Projekti i pemëtarisë – furnizimi e trajnimi (në vazhdim e sipër).

**1 – Fushat eksperimentale në perimtari.....9 631.02 €**

Projekti i shpërndarjes së serrave në fshatrat: Besi, Bardhosh, Marefc, Barilevë, Prugofc dhe Hajvali.

Shpërndarja është bërë me ndihmën e kryetarëve të fshatrave , komisionit për fshatra , komisionit nga Sektori i bujqësisë dhe Komitetit për zhvillim rural.

Janë shpërndarë gjithsej 60 serra.

### **Arsyet e realizimit të projektit janë:**

- mundësia e punësimit në kuadër të ekonomive familjare,
- prodhimtaria e përhershme e perimeve dhe
- qarkullimi bujqësor si masë e një bujqësie intesive .

### **2.- Furnizimi me llakto-friz për fermerët në Keqekollë**

Duke u bazuar në kërkesën e fermerëve dhe Kooperativës bujqësore me seli në fshatin Keqekollë, Drejtorati i Zhvillimit Rural vendosi që të furnizojë me një llakto-friz, me kapacitet prej 1 000 l, për grumbullimin e qumështit në këtë anë.

**Vlera e llakto-frizit është 4 500.00 €**

### **3.- Raporti përfundimtar për dëmet e shkaktuar nga të reshurat në BL- Barilevë**

Në bazë të kërkesës së bërë nga Abdyrrahman Verbovci nga Barileva, e cila ka të bëjë me dëmet e shkaktuara nga vërshimet ( 7,8,9,10/05/2005 ), me ç'rast lumi Llap ka dal nga shtrati dhe ka vërshuar sipërfaqe të tëra me kultura bujqësore (patate), Drejtorati i Zhvillimit Rural - Sektori për bujqësi, formoi komisionin profesional për vlerësimin e dëmeve, i cili më 23.05.2005 vizitoi parcelat e fermerëve të dëmtuar nga vërshimet dhe konstatoi se:

- sipërfaqet e mbjella me patate kanë qenë të mbuluara me ujë 4 ditë të plota,

- vegjetacionin mbitokësor (kërçelli dhe gjethet) është dëmtuar mbi 80%,
- nga vërshimet janë përfshirë sipërfaqe të tëra rreth shtratit të lumit Lllap,
- janë shkaktuar dëme të mëdha (80%), në sipërfaqe prej 2.05 ha.

#### **4. Projekti i veterinës mobile**

Me këtë projekt është paraparë që të bëhet mbarsim artificial, me qëllim të përmirësimit racor. Ky projekt është duke u realizuar dhe përfshin kryesisht rajonet kodrinoro-malore.

**Vlera e projektit mbërrinë shumën 9 533.73 €**

#### **5. Projekti për eliminimin e qenve endacakë**

Ky projekt ka filluar së realizuari më 04.04.2005 dhe ka zgjatur deri më 15.05.2005. Gjatë këtij operacioni janë eliminuar gjithsej 515 qen endacakë.

**Vlera e projektit mbërrinë shumën 8 450.00 €**

#### **6. Projekti i pemëtarisë – furnizimi e trajnimi ( në vazhdim e sipër)**

Me këtë projekt është paraparë që të bëhet mbjellja e 1 400 fidanëve me pemë (mollë, kumbull) në lokacionet e shkollave fillore në Ballaban, Koliq, Keqekollë, Dabishefc, Marefc dhe Prapashticë.

Projekti është në vazhdim e sipër.

**Vlera e projektit mbërrinë shumën 9 740.00 €**

#### **7. Projekti i pemëtarisë – furnizimi e trajnimi**

**Arsyeja e realizimit të projektit janë:**

- promovimi në përmirësimin e qëndrueshmërisë së prodhimtarisë pemëtoze,
- ngritja e kapaciteteve profesionale te fermerët dhe shoqatat e fermerëve,
- shtimi i sipërfaqeve të mbjella me pemishte dhe
- mundësia e zhvillimit të një bujqësie intensive.

Është bërë shpërndarja e gjithsej 1 400 fidanëve me mollë dhe kumbull, në gjashtë shkolla fillore ( Koliq, Keqekollë, Ballaban, Prapashticë, Dabishefc dhe Marefc). Sipërfaqja e përgjithshme e mbjell me fidanë është përafërsisht 1.20 ha (në secilën shkollë me nga 0.20 ha).

**Vlera e projektit mbërrinë shumën 9 740.00 €**

<b>Spektori për zhvillim rural gjithsej.....</b>	<b>1 145 397.16 €</b>
<b>Spektori për bujqësi gjithsej.....</b>	<b>41 854.75 €</b>
<b>Totali.....</b>	<b>1 187 251.91 €</b>

### **XI. DREJTORATI I KADASTRIT DHE I GJEODEZISË**

Në periudhën raportuese, organi është angazhuar në zgjidhjen e kërkesave të drejtuar këtij drejtorati nga personat fizikë dhe juridikë, siç janë: organet e administratës komunale, institucionet që qeverisen nga Komuna, (Shëndetësia dhe Arsimi), ndërmarrjet komunale, ministritë si IPVQ, Agjencia Kadastrale e Kosovës, Agjencia Kosovar e Mirëbesimit etj.

Gjatë periudhës raportuese nga ky drejtorat u kryen këto shërbime:

- mbajtja e evidencës së intabulimeve – hipotekave,
- dhënia e aktvendimeve për kredi sipas kërkesave të bankave komerciale,
- organizimi i futjes së të dhënave në RDPP (regjistri i të drejtave të pronave të paluajtshme) dhe trajnimin e personelit për përpunimin e të dhënave me softuer të RDPP-së, në bashkëpunimi me Agjencinë Kadastrale të Kosovës,
- fillimi i përpunimit të informacioneve kadastrale për zonën kadastrale Sefali, në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale.

Vështirësitë e paraqitura në vitin paraprak kanë mbetur edhe në vitin për të cilin po raportojmë. Është fjala për mungesë të elaboratit kadastral, si ai juridik ashtu edhe ai teknik, i cili gjendet në Kryshefc të Serbisë, mjetet për incizim në terren etj..

Në vijim paraqitet pasqyra e kërkesave ushtruar këtij drejtorati.

### **Kërkesa për dalje në terren:**

Gjithsej .....	766
Të personave fizikë.....	577
Të personave juridikë.....	54
Të kryera.....	631
Në procedurë për vitin vijues janë bartur .....	135

### **Kërkesa për ndërrim në operat kadastral:**

Gjithsej .....	1671
Të kryera .....	1640
Të bartura.....	31
Të miratuara.....	1633
Të refuzuara.. .....	7

### **Kërkesa për intabulim – hipotekë:**

Gjithsejtë .....	632
Për regjistrim .....	612
Për çregjistrim.....	20

### **Kërkesa për lëshimin e certifikatave, fletëve poseduese dhe kopjeve të planit:**

Gjithsej.. .....	14680
Certifikata.....	7260
Fletëposedime.....	3854
Kopje të planit.....	3566

## XII. DREJTORATI I SHËRBIMEVE PUBLIKE, TRANSPORTIT, MBROJTJES SË AMBIENTIT DHE I TOKËS NDËRTIMORE

Me qëllim të kompletimit dhe realizimit sa më të mirë të projekteve, ky drejtorat ka bashkëpunuar me DUPN-në, DGJK-në dhe Drejtoratin e Financave dhe të Pronës. Aktivitetet e veta, drejtorata i ka zhvilluar konform planit të punës për vitin 2005.

### **Shërbimi juridik**

Ky shërbim gjatë kësaj periudhe ka hartuar dhe proceduar për miratim në Kuvend: **Rregulloren për transportin rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave** (miratuar më 29.12.2005), **Rregulloren për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve** (miratuar më 29.12.2005), **Rregulloren për transportin me merimangë** (miratuar më 14.06.2005), **Rregulloren për mbrojtjen e mjedisit, Rregulloren për mbrojtjen e ajrit dhe Rregulloren për rrugë lokale.**

Ka pranuar 931 kërkesa, prej të cilave 927 janë zgjidhur, kurse 4 kërkesa janë bartur në vitin vijues.

### **1. SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE**

#### **Kanalizimi**

- Hartimi i paramasës me paralogari për pastrimin e lumit "Prishtina";
- Hartimi i paramasës me paralogari për pastrimin e rrjetit të kanalizimit atmosferik në qytet.

Në mungesë të mjeteve financiare projektet e lartpërmendura nuk janë realizuar.

Është bërë sanimi i rrjetit të ngrohjes në disa rrugë të qytetit (investimi i Ngrohtores).

#### **Higjiena publike në qytet:**

Gjatë periudhës raportuese është bërë pastrimi i qytetit, larja e rrugëve dhe trotuareve.

Nga 53 rrugë sa janë pastruar, 19 rrugë i janë besuar NP "PASTRIMI" nga Prishtina dhe 34 rrugë për pastrim i janë besuar kompanisë "TOIFOR" nga Prishtina.

Projekti për pastrimin e rrugëve është kryer me sukses dhe ka përfunduar më 15.11.2005, në vëllim financiar prej .....

Mirëmbajtja dimërore për periudhën 15.11.2004 deri më 15.03.2005, është ndarë në tri grupe:

- Grupi i parë i është besuar kompanisë "V Z -kompania", për 35 rrugë, në gjatësi 26.16 km, sipas kontratës nr.05 224 521, të dt.17.11.05, në vlerë prej .....267,526 € ditore;

- Grupi i dytë i punëve i është besuar SHPK "TOIFOR", për 43 rrugë, në gjatësi 19.37 km, sipas kontratës nr.05 224 521, të dt.17.11.2005, në vlerë prej .....252,38€ ditore;

- Grupi i tretë i punëve i është besuar NR "PASTRIMI", për 58 rrugë, në gjatësi 31.05 km, sipas kontratës nr.05 224 521, të dt.17.11.05, në vlerë prej..... 204,54€ ditore.

Furnizimi me krip dhe zhavorr për 3 kompanitë..... 25.698,00 €.

Në lëmin e higjienës janë pranuar 72 kërkesa të cilat janë zgjedhur. Prej tyre 27 janë fatura, ndërsa 45 të ndryshme.



## **Shërbimi elektroenergjetik**

Këtij shpërbimi për punë i kanë arritur 133 kërkesa. Prej tyre 132 janë zgjidhë, ndërsa 1 kërkesë është në procedurë e sipër.

Projektet e realizuara në ndriçimin publik dhe vendosjen e semaforëve:

### **Ndriçimi publik:**

- ndriçimi publik në rr."Shpëtim Rrobaj", në vlerë prej .....141.960,60€;
- vendosja e inventoreve në 6 nyja semaforike, në vlerë prej .....22.336,80€;
- ndriçimi publik në rr."I.Gjilani", në vlerë prej .....24.260,00€;
- montimi i trafos në parkun rajonal "Gërmia"dhe"Veternik", në vlerë prej.....39.768,15€.

### **Mirëmbajtja dhe sanimi i ndriçimit publik**

Për sanimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik për vitin 2005, kanë qenë të siguruara mjetet nga buxheti i Komunës së Prishtinës, në shumë prej 200.000,00 €.

Në bazë të kontratës nr. 3 – 5/05, të dt. 12.04.2005, punët për mirëmbajtjen e ndriçimit publik i janë besuar N.P. "Monten" nga Prishtina, e cila deri më 31.12.2005 e ka realizuar tërësisht programin për vitin 2005.

Krahasuar me vitin 2004, që kanë qenë 112 rrugë të ndriçuara, gjatë vitit 2005, me sanimin edhe të 58 rrugëve dhe ndërtimin e 7 rrugëve të reja me ndriçim publik, kemi pasur 177 rrugë të ndriçuara.

### **Mirëmbajtja e semaforëve**

Në bazë të kontratës nr. 2 – 5/05, të dt. 31.03.2005, punët për mirëmbajtjen e semaforëve i janë besuar DPZ "Jame" nga Prishtina, në vlerë prej .....77.280,00 €.

### **Shfrytëzimi i hapësirës publike**

Gjatë kësaj periudhe kanë arritur gjithsej 354 kërkesa për shfrytëzimin e hapësirave publike para lokaleve, stendave lëvizëse dhe panove. Prej tyre 238 janë miratuar, 115 janë refuzuara dhe 1 është në procedurë të zgjidhjes.

Të hyrat nga shfrytëzimi i hapësirave publike para lokaleve, stendave, reklamave dhe gjeneratorëve 198.499,00€.

1.Participimi i qytetarëve në ndërtimin e infrastrukturës.....	184.442,50 €
	400,00 \$
2.Gropimet e kanalit për shtrirjen e kablove energjetike.....	320,00 €
3.Parkingjet.....	72.733,00 €
4.Laura te pishina e Gërmisë.....	62.646,00 €
Gjithsej të hyra.....	518.640,50 €
	400,00 \$

## **2.SEKTORI I TOKËS NDËRTIMORE**

Sektorit të tokës ndërtimore i kanë arritur 64 kërkesa, të gjitha janë kryer. Kërkesat kanë të bëjnë me hartimin e paramasës me paralogari, për ndërtimin e infrastrukturës me participimin e komunitetit.

### **Rrugët**

Realizimi i projekteve për ndërtimin e infrastrukturës rrugore është dhënë në formë tabelore si në vijim:

## INVESTIMET E BARTURA NGA VITIT 2004-2005

Nr.	RRUGA	AKTIVITETI	PUNËKRYESI	GJATËSIA m'	VLERA ( € )	E realizuar Viti 2005
1.	"Ahmet Krasniqi"	Asfaltim Trotuare	"Ekskavatori", "Dijarco"	1870.3 580.0	238.571,35	25/04/2005 26/01/2005
2	"Mentor Retkoceri"	k.atmosferik ndriçim,k.kablovik	"Gashi Co"	199.12	115.257,35	07/01/2005
3	"Mic Sokoli"	Kan.asfaltim	„Coaling"	209.00	132.950,04	12/08/2005
5	Sanimi i gropave	Asfalt	„Unicom"	-	30.000,00	13/07/05
6	"Adrian Krasniqi"	Asf.kan.ujësjellës	„Plan Kos"	250.00	186.053,65	20/07/05
7	"Bedri Gjini"	Asfaltim	"Eng Pan All"	350.00	46.206,96	23/05/2005
8	"Ymer Lutfi Paçarizi"	Rruga me kubza pa trotuar	„Euro Garten"	340,00	40.855,00	01/05/2005
9	Shkodra dhe AB	Rruga me kubëza	"Alkoimpex"	567,00	65.225,53	01/07/2005
10 11 12	"Edmond Hoxha" "Shaip Kamberi" "Mustafë Kruja"	Kubëza	"Protech"	1077.00	237.596,21	08/06/2005
13	"Sylejman Vokshi" dhe "2 Korriku"	Asfaltim,kan.fekal Ndiçim, shenjëzim	„Alko-Impex"	366.00	184.266,44	05/07/2005
14	"Gazmend Zajmi" "RrahimBeqiri"dhe "Xheladin Hana"	Asfaltim,trotuare Shenjëzim	„Agro Llapi" Kastrioti" „Monteni"	1900.00	223.157,67 272.002,74 88.550,00 <hr/> 583.710,41	28/07/2005 28/09/2005 07/02/2005
15	"Meto Bajraktari"	Kubza	„Eurogarden"	275.00	49.359,61	22/04/2005
16	"Ali Hadri" dhe "Zenel Salihu"	Asfaltim, rigola	„Eng Pan All"	752.00	96.299,02	16/05/2005
17	"Sejdi Kryeziu" "Pashko Vasa"	Asfaltim,trotuari Me kubëza	„Eurogarden"	505.00	132.956,00	29/06/2005
18	"Mujo Ulqinaku", "Radovan Zogoviq"	Asfaltim, trotuar me kubza	„Eskavatori"	527.00	106.820,98	14/07/2005
19	Platoja te pllaka përkujtimore „ "Enver Maloku"	Punimi i trotuarit dhe plakës përkujtimore	„Las Palmas" „Paradiso"	600 m <sup>2</sup> 110 m <sup>2</sup>	19.222,56 34.928,80 <hr/> 54.151,36	13/12/2005
20	"Vushtrisë"	Asfaltim,k.atm.kabl dhe ndriçim	"Unicom"	740.00	336.335,57	25/04/2005
21	"Drenica", "Llapi"	k. atmosferik	„Gashi Ing"	725.00	98.547,54	22/04/2005
22	"Haxhi Zeka"	Asfaltim,kanalizim atmosferik, trotuare, sinjalizim dhe ndriçim publik	„Eskavatori"  „Termomontim"	1.737,22  1.737,22	572.684,22  222.719,35	7/10/2005
23	"Caraleva"	Asfaltim,kanalizim atmosferik,sinjalizim ndriçim publik	„Beni Com"	696,00	386.973,90	1/12/2005

## INVESTIMET NË VITIN 2005

Nr.	RRUGA	AKTIVITETET	PUNËKRYESI	GJATËSIA	VLERA(€)	E REALIZUAR
1	"Xhemail Prishtina"	K.fekal,atmosferi k,n.publik dhe kubza	„Labi”	160.00	46.487,83	20/07/2005
2	"Sali Nivica", "Bedri Shala" (krahu i djathtë)	Kubza, kanalizim fekal dhe atmosferik	„Eurogardeni”	460.00	136.353,44	29/11/2005
3	"Mark Isaku"	Asfaltim,k.atmosf .fekal,n.publik dhe kablllovak	„Unicom”	375.00	209.039,60	14/12/2005
4	"Johan Gete", "24Maji" dhe "Bekim Berisha"	Kubza	„Eurogardeni”	680.00	104.976,52	13/12/2005
5	"Fehmi Krasniqi", "D.Prapashticës", "S.Matoshi", "N.Veqilharxhi" dhe "Xhafer Deva"	Kubza	„Viadukti”	777.00	108.936,65	8/11/2005
6	"Osman Bunjaku"	Kubza	„Getoari”	180.00	33.376,56	16/11/2005
7	"Rexhep Shema"	Kanalizimi fekal dhe atmosferik	„Noti”	631,32  637,32	99.941,37	4/11/2005
8	"Adrian Krasniqi" -vazhdim	Kubza	"Eurogarden"	467,00	66.766,12	13/07/2005
9	"Abedin Rexha"	N.publik në shtylla të drunjta	"El trafomont”	295	3467,25	11/04/2005
10	"Xhevat Begolli"	K.fekal dhe Atmosferik	„Noti”	837.00	89010,49	9/06/2005
11	"Lec Gradica"	Asfaltim	"Diarco"	550.00	120658,80	25/10/2005
12	"Tringë Smajli" me rr.lidhse "Gjon Sereçi	Asfaltim	"Diarco"	295.00	30459,24	25/07/2005
13	"Ibrahim Fehmiu"	Zhavorr	"Cosnor Enterprise"	366.00	60051,50	11/08/2005
14	"Drenica"	Rruga asfaltim	"Eng Pan All"	440,00	87.000,00	22/05/2005
15	Parkingu në rr. "Fehmi Agani"	Kubza	„Las Palmas”	30	5.642,98	25/10/2005
16	"Mehmet Akif Ersoy"	Asfaltim	"Diarco"	625	67.447,40	14/07/2005
17	"Qamil Hoxha" "Tringë Smajli"	Kubza (riparim) dhe ndriçim	"Eurogarden"	970 m <sup>2</sup> 1660 m <sup>2</sup>	530.020,45	07/12/2005
18	"Enver Maloku"	Kanalizimi atmosferik	"Proart"	90	1938,41	07/10/2005s

## INVESTIMET E BARTURA NGA VITI 2005-2006

Nr.	RRUGA	AKTIVITETI	PUNËKRYESI	Gjatësia m	Vlera(€) e kantatës	Realizimi
1	"Rexhep Shema"	Asfaltim	Viktoria Invest	446.11	160.697,72	63.815,78
2	"Çeta e Llapit"	Asfaltim,k.fekal,atmosferik n.publik dhe kabllorik	"Getoari"	394.55	179.391,00	79.590,47
3	"Holgen Petersen"	Asfaltim,k.fekal atmosferik n.publik dhe kabllorik	"Labi"	616.00	227.373,13	52.840,90
4	"Shaban Shala"	Asfaltim,k.fekal dhe atmosferik	"Ndërtimi"	700	236.342,57	44.248,42
		n.publik,k.kabllorik dhe rrjeti i tensionit të ulët-	NP"Monten"	600	69.299,00	Nuk ka realizim pagese
5	"Dëshmorët e Marecit"	Asfaltim,n.publik k.kabllorik	Unicom N.P"Monten"	544,52	264.405,27 46.391,00	73.519,61 46.391,00
6	"Jakup Ferri"		"Labi"	201,07	51.350,86	
7	"Xheladin Kurbaliu", "Llapi" dhe "Abedin Rexha"	Asfaltim,trotuar me kubza	"Shkoza"	190 156 300	57.922,10	17.818,86
8	"Nuhi Berisha"	Asfaltim,kanalizim fekal , atmosferik ndriçimi publik dhe sinjalizi.H.V	"Albaniku"	378	126.743,95	24.904,09
9	Segmenti rrugor "Xhavit Ahmeti"	Asfaltim,kanalizimi atmosferik ,fekal dhe ndriçim publik	"Unicom"	280	237.398,31	100.072,20
10	"27Nëntori"-ndriçimi publik dhe k.kabllorik		"Unicom" NPN"Linda" Kaçanik	1960	520.000,00	468.000,00
					186.737,00	80.073,92

Gjatë vitit 2005 janë ndërtuar :

1. 13.683,42 m rrugë me asfalt,
2. 5915,00 m me kubza,
3. 400 m me zhavorr.

### **3. SEKTORI I TRANSPORTIT**

Përqendrimi i aktiviteteve të këtij sektorikanë qenë në transportin publik, sinjalizimet në përgjithësi dhe parkingjet.

#### **Transporti publik**

##### **a). Organizimi i transportit**

1. Shqyrtimi i dokumentacionit të aplikuesve për operim në transportin publik urban dhe urbano-periferik ;
2. Është përgatitur dhe dërguar në Departamentin e Prokurimit materiali për tender për kompanitë për tërheqjen e automjeteve;
3. Inicimi dhe vazhdimi i bisedimeve me komunat Fushë-Kosovë dhe Obiliq rreth organizimit të transportit publik mes tri komunave, në bashkëpunim me MTPT
4. Bisedimet me përfaqësuesin e Bankës Botërore rreth programit të investimeve për qytetin e Prishtinës, në mënyrë që të bëhet përmirësimi i transportit, parkingjeve publike dhe i semaforëve etj..

##### **b.) Parkingjet**

Është bërë matja e parkingjeve publike në rrugët e qytetit, përgatitja e materialit për tender dhe procedimi në Departamentin e Prokurimit ;

Dhënia në shfrytëzim me koncesion e parkingjeve publike, të ndara në katër loto :

- NTP "LTG" (NTP"Park-Project"), loto I dhe II,
- Kompania "Beni Dona-Plast", loto III dhe IV.
- NN "Mala",
- Parkingjet e rezervuara .

##### **c). Sinjalizimi horizontal dhe vertikal**

Menaxhimi i projektit për sinjalizim në rrugët e qytetit :

- në 13 vende janë vendosur 13 tabela udhërrëfyese dhe 11 tabela orientuese,
- në 13 vende janë vendosur 132.5 metra ngadalsues të shpejtësisë prej gome,
- është bërë sinjalizimi vertikal në 50 rrugë në komunën e Prishtinës, ndërsa sinjalizimi horizontal në 24 rrugë, gjithashtu me sinjalizim vertikal dhe horizontal janë pajisur 34 udhëkryqe.

#### **SHËRBIMI I MBROJTJE SË AMBIENTIT**

Mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbëruara të qytetit ka qenë e ndarë në dy loto .

##### **Lotoja e parë përfshinë :**

- sipërfaqet e gjelbëruara te " Përmendorja e Dëshmorëve ", në sipërfaqe prej....53.000 m<sup>2</sup>,
- sipërfaqet e gjelbëruara në lagjen "Ulpiana", në sipërfaqe prej .....96.000 m<sup>2</sup>.

Mirëmbajtjen e sipërfaqeve të kësaj lotoje e bëri NPK "Hortikultura", vlera e kontraktuar ka qenë 56.261,60 €.

### **Lotoja e dytë përfshinë :**

- sipërfaqet e gjelbëruara në lagjen " Dardania ", gjithsej..... 76.000 m<sup>2</sup>,
- sipërfaqet e gjelbëruara në Qendër të Qytetit ", gjithsejt.....75.000 m<sup>2</sup>.

Mirëmbajtjen e këtyre sipërfaqeve e ka bërë NTP "Labi", në vlerë prej 65.439,50 €.

Gjatë kësaj periudhe kohore është bërë finalizimi i projekteve të gjelbërimit :

Projekti "Gjelbërimi i oazave", duke filluar nga depot e NSH "Ramiz Sadiku", deri te ndërtesa e OSBE –së";

- Projekti "Gjelbërimi i oazave" përgjatë rrugës "Xheladin Rekaliu" dhe "Enver Maloku ";
- Projekti "Gjelbërimi i sipërfaqes në lagjen " Kodra e Diellit "" – blloku I;
- Projekti "Ndërtimi i trotuareve dhe platos te pllaka përkujtimore e Enver Malokut ";
- Projekti "Rregullimi i sipërfaqeve gjelbëruese në lagjen " Kodra e Diellit "" blloku II, ku punëkryes ishte NTP " Las Pallmas ";
- Projekti "Mirëmbajta e sipërfaqeve gjelbëruese në qytetin e Prishtinës", i realizuar mes Komunës së Prishtinës, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe UNDP-së.

Duhet theksuar se Shërbimi i mbrojtës së ambientit, gjatë kësaj periudhe ka pranuar 29 kërkesa nga qytetarët të cilat i ka shqyrtuar në afatin e paraparë ligjor.

## **XIII.DREJTORATI I SIGURISË CIVILE DHE I EMERGJENCËS**

Për vitin raportues ky drejtorat i ka kushtuar një angazhim të përhershëm hartimit të Planit të reagimit emergjent në rast të fatkeqësive natyrore, si dhe fatkeqësive tjera, formimit dhe plotësimit të ekipeve në shtabet e Mbrojtjes Civile me personel përkatës, trajnimit të pjesëtarëve të rinisë së qytetit për zjarrfikës në Qendrën e Trajnimit në Vushtrri ( 15 veta), trajnimit të zjarrfikësve-punëtorë të sigurimit të Kuvendit të Komunës, si dhe trajnimit të operatorëve të Qendrës Komunale për Informim, Alarmim dhe Koordinim dhe të organizimit të ushtrimit praktik në Ndërmarrjen Publike Banesore.

### **1.SEKTORI I SIGURISË CIVILE**

.Gjatë periudhës raportuese Sektori i Sigurisë Civile është angazhuar për realizimin e punëve dhe aktiviteteve të planifikuara sipas Planit vjetor të punës dhe atë:

\* Hartimi i programit të punës me detyrat dhe objektivat orientuese të prioriteteve mbi organizimin e Sigurisë Civile në Komunë, me theks të veçantë në bashkësitë lokale dhe ndërmarrjet publike – private në territorin e komunës.

\* Pjesën dërmuese të aktiviteteve dhe veprimeve i kemi realizuar në bashkëpunim me subjektet gjegjëse, duke i angazhuar ekipet profesionale, gjë që ka rezultuar si metodë e suksesshme e punës të cilën do ta preferojmë edhe në të ardhmen. Një kujdes të veçantë edhe gjatë këtij viti i kemi kushtuar formimit dhe plotësimit të shtabeve lokale nëpër bashkësi lokale, si dhe formimit të ekipeve të MC-së në BL-së si struktura ekzekutuese në

rast të fatkeqësive elementare dhe fatkeqësive tjera në territorin e Komunës së Prishtinës. Nisur nga fakti se këto struktura janë të organizuara në mënyrë vullnetare, nuk kemi pasur pengesa, përkundrazi interesimi i strukturave në BL dhe i qytetarëve ka qenë në nivelin e duhur. Gjatë periudhës raportuese janar – dhjetor 2005, kemi formuar shtabet lokale në Bashkësinë e 14 dhe të 15 lokale.

\*Ekipet e MC-së dhe E-së, në kuadër të shtabeve janë formuar në këto bashkësi lokale: 1,2,6,7,8,10,12,12<sub>1</sub>,12<sub>2</sub>,14,15, në këto fshatra: Hajvali, Keqekollë, Koliq,Bardhosh, Barilevë, Slivovë, Makoc, Dabishec, Mramor, Prugoc, Shkabaj dhe Besi.

\* Vlenë të ceket se këto shtabe dhe ekipe nëse mbetën vetëm me pjesëtarë, pa u pajisur me mjete themelore për intervenim, nuk do të kenë efektin e vetë, prandaj prioritet i yni për vitin vijues është që të bëjmë plotësimin me mjete adekuate për intervenim, si dhe trajnimin e pjesëtarëve të tyre në qendrat adekuate të trajnimit.

\* Inspektorët e MC-së, gjatë vitit raportues, aktivitetin e vetë e kanë përqendruar në mbikëqyrjen dhe inspektimin e subjekteve të përcaktuara me prioritet, gjithsejt në 37 subjekte, për të cilat kanë hartuar procesverbalet dhe janë propozuar mbi 200 masa të sigurisë civile.

Është me rëndësi të ceket se gjatë inspektimit të këtyre subjekteve është konstatuar se asnjëri prej tyre nuk posedojnë kurrfarë dokumenti të Planit të sigurisë civile. Njëherësh është vlerësuar se kuadrot ekzistuese përgjegjëse për Siguri Civile s'janë aftësuar për intervenim emergjent në shumicën e subjekteve të vizituara. Në bazë të programit të punës për periudhën korrik – dhjetor 2005, është kryer inspektimi i objekteve të banimit me lartësi mbi 12 metra, në 39 raste në Bashkësinë e pare dhe të dytë lokale, me ç'rast janë evidencuar të metat, dobësitë dhe keqpërdorimet e sipërfaqeve publike dhe sipërfaqeve tjera që paraqesin rrezik për jetën dhe pasurinë e qytetarëve. Për eliminimin e tyre janë propozuar 47 masa, me të cilat kërkohet ndërmarrjen e veprimeve të menjëhershme nga se paraqesin rrezik për jetën dhe pasurinë e qytetarëve.

Bazuar në programin e punës së Drejtoratit, Sektori i SC-së ka hartuar Planin për trajnim dhe aftësim të pjesëtarëve të BZP-së dhe rinisë së qytetit në bazën vullnetare, ku interesimi i rinisë ka qenë i madh dhe, mu për këtë, kemi dërguar në trajnim në Qendrën e Trajnimeve në Vushtrri 15 të rinj, të cilët me sukses e kanë përfunduar këtë trajnim dhe janë pajisur me certifikata adekuate.

Në kuadër të kësaj i kemi dërguar për trajnim një numër të punëtorëve të sigurimit të Komunës për aftësim të përdorimit të mjeteve teknike kundër zjarrit në rast nevojë.

## **2.SEKTORI I EMERGJENCËS**

Hartimi i Planit të reagimit emergjent është punuar pas grumbullimit të informatave të domosdoshme nga të gjitha drejtoritë komunale, e që kanë të bëjnë me kapacitetet njerëzore, teknike e materiale, mjetet e domosdoshme për realizim, pozitën gjeostrategjike të komunës dhe kapacitetet prodhuese e shërbyese.

Në bazë të rrethanave të krijuara është punuar edhe në azhuritetin e Planit të gatishmërisë emergjente, si dhe vlerësimit të rrezikut për Komunë, duke koordinuar dhe bashkëpunuar me subjektet gjegjëse, siç janë; TMK-ja, Brigada e Mbrojtjes Civile- në kuadër të TMK-së, SHPK-ja, UNMIK-u, Qendra e Mjekësisë Familjare, Enti i Ndihmës së Shpejtë Emergjente, Kryqi i Kuq, KEK-u, Ujësjiellësi dhe ndërmarrjet tjera publike.

Në kuadër të këtij Sektori, për nevojat komunale vepron QIAK-ja, e cila aktivitetin e vetë e zhvillon gjatë 24 orëve përmes operatorëve, e cila është e pajisur me aparaturë moderne. Kjo qendër luan rol të rëndësishëm në marrjen dhe shkëmbimin e informative mes

subjekteve komunale dhe më gjerë, e sidomos në raste emergjente. Përmes kësaj qendre mbahet evidenca e hyrje-daljeve të shërbyesve civilë në Komunë, të cilat ia distribuon Bordit të drejtorëve në fund të çdo jave. Për funksionim normal të kësaj qendre është vendosur repetitori i radiolidhjeve në Butofc, i cili mundëson dëgjueshmëri solide dhe komunikim efikas me BL-të dhe ndërmarrjet publike përmes radiolidhjeve, për të cilin kujdeset kompania “Profesional Alarm”, dhe ky shërbim ka kushtuar 5941,30 €. Vlen të ceket se gjatë vitit raportues janë organizuar disa herë trajnime profesionale me operatorët e Qendrës.

## **PARAQITJA TABELARE**

	<b>Muaji dhe viti 2005</b>											
<b>Subjektet-kompanitë komunale</b>	<b>I</b>	<b>II</b>	<b>III</b>	<b>IV</b>	<b>V</b>	<b>VI</b>	<b>VII</b>	<b>VIII</b>	<b>IX</b>	<b>X</b>	<b>XI</b>	<b>XII</b>
<b>SHPK-ja</b>	7	3	15	6	6	3	2	3	3	4	6	2
<b>TMK-ja</b>		2	1		1	1		1				
<b>EMU-ja</b>	1	2	6	3	2	3	1		3		4	3
<b>BGZ-ja</b>	24	25	40	38	18	11	18	16	12	22	30	20
<b>KEK-u</b>	1	5	5	4	11	2	4	3	12		11	17
<b>Komp.mirë.rrugore</b>	26	25	21	3	9	6	7	2	5	4	16	19
<b>Hortikultura</b>	1		2	1		1	1		1		1	
<b>Termokosi</b>							1			1	1	1
<b>Ujë.raj. Prishtina</b>	7	9	8	5	10	3	19	25	21	14	16	12
<b>Komp.mir.semaforve</b>		2	8	14	8	2	7	11	3	7	6	2
<b>Komp.mir.parqeve</b>												
<b>Komp.për.ndr.rrug.</b>		1	3	12	1	1	1	5	2		1	4
<b>Ins.i tregut, sanitar</b>	1	2	8	9	7	8	5	8	4	4	5	6
<b>Ins.kom.i ndërtimt.</b>	5	1	11	13	25	11	27	21	21	15	12	8
<b>Ins.e preventiveës</b>	1	5	2	3	2	2	2		2	3	6	1
<b>KFOR-i</b>		2	1		1						1	
<b>Të ndryshme</b>		3	6	5	6	5	8	9	2	12	7	6
<b>DMCE-ja</b>			2		2	1	1	2		1	1	
<b>Gjithsej intervenime</b>	<b>75</b>	<b>87</b>	<b>139</b>	<b>117</b>	<b>110</b>	<b>60</b>	<b>104</b>	<b>106</b>	<b>91</b>	<b>87</b>	<b>124</b>	<b>100</b>

**Intervenime për vitin 2005 ishin gjithsej: 1200**

tabela: nr- 1



Inspektorët e Preventiveës dhe hulumtimit të zjarrit të KK-së së Prishtinës aktivitetin e vet e kanë shtrirë edhe në Komunën e Fushë-Kosovës dhe të Obiliqit. Përqendrimi i inspektorëve në fjalë ka qenë në kontrollimin e ndërmarrjeve publike dhe private, të subjekteve juridike, në hulumtimin e zjarreve, përpilimin e procesverbaleve me propozim të masave adekuate, përpilimin e aktvendimeve me urdhëresave me afate të caktuara për eliminimin e parregullsive të gjetura gjatë kontrollimeve.

Vlen të ceket se në territorin e Komunës funksionojnë 48 pika shpërndarëse të karburanteve, të cilat gjatë periudhës raportuese janë inspektuar, kontrolluar nga inspektorët e preventivës.

Inspektimin e stacioneve të karburanteve e kanë kryer edhe në Fushë-Kosovë ( 12 pika shpërndarëse), si dhe në Obiliq (8 pika shpërndarëse).

Aktiviteti i inspektorëve të Preventivës dhe hulumtimit të zjarrit pasqyrohet në formularin A.

## PASQYRA TABELARE

	<b>Aktiviteti</b>	Tremujori I nr.	Tremujori II nr.	Tremujori III	Tremujori IV	Gjithsej	Gjithsej
I.	<b>Inspektimi i rregullt subjekteve ( Proceset ) private, juridike</b>	<b>62</b>	<b>46</b>	<b>37</b>	<b>28</b>	<b>173</b>	
		<b>50</b>	<b>43</b>	<b>32</b>	<b>22</b>	<b>147</b>	
		<b>12</b>	<b>3</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>26</b>	
a)	<b>Numri i objekteve</b>	<b>75</b>	<b>46</b>	<b>55</b>	<b>35</b>	<b>211</b>	
b)	<b>Kategoria I</b>	<b>4</b>	<b>2</b>	<b>-</b>		<b>6</b>	
c)	<b>Kategoria II</b>	<b>40</b>	<b>35</b>	<b>10</b>	<b>12</b>	<b>97</b>	
ç)	<b>Kategoria III</b>	<b>25</b>	<b>5</b>	<b>35</b>	<b>13</b>	<b>78</b>	
d)	<b>Kategoria IV</b>	<b>6</b>	<b>4</b>	<b>10</b>	<b>10</b>	<b>30</b>	
e)	<b>Numri i masave nga proceset</b>	<b>367</b>	<b>254</b>	<b>200</b>	<b>154</b>	<b>975</b>	
II.	<b>Aktvendimet: -private -juridike</b>	<b>40</b>		<b>22</b>	<b>31</b>	<b>126</b>	
		<b>32</b>	<b>33</b>	<b>20</b>	<b>25</b>	<b>107</b>	
		<b>8</b>	<b>30</b>	<b>2</b>	<b>6</b>	<b>19</b>	
		<b>3</b>					
a)	<b>Nr.i objekteve</b>	<b>55</b>	<b>33</b>	<b>35</b>	<b>35</b>	<b>158</b>	
b)	<b>Kategoria I</b>	<b>4</b>	<b>-</b>	<b>-</b>		<b>- 4</b>	
c)	<b>Kategoria II</b>	<b>10</b>	<b>25.</b>	<b>10</b>	<b>13</b>	<b>58</b>	
ç)	<b>Kategoria III</b>	<b>35</b>	<b>5</b>	<b>20</b>	<b>12</b>	<b>72</b>	
d)	<b>Kategoria IV</b>	<b>6</b>	<b>3</b>	<b>5</b>	<b>10</b>	<b>24</b>	
	<b>Numri i masave Nga akt.vendim.</b>	<b>235</b>	<b>166</b>	<b>113</b>	<b>164</b>	<b>678</b>	
III.	<b>Nr.i masave të pruara: a) nga procesverbalet b) nga aktvendimet</b>	<b>602</b>	<b>420.</b>	<b>313</b>	<b>318</b>	<b>1653</b>	
		<b>367</b>	<b>254</b>	<b>200</b>	<b>154</b>	<b>975</b>	
		<b>235</b>	<b>166</b>	<b>113</b>	<b>164</b>	<b>678</b>	
	<b>Kontrollimi dhe</b>						<b>6.të vdekur</b>

IV.	hulumtimi i zjarreve	9	15	4	12	40	dhe 10 persona të lënduar
-----	----------------------	---	----	---	----	----	---------------------------

Shërbimi i zjarrfikjes, në kuadër të BZP-së është specializuar dhe aftësuar për fikjen e zjarrit, shpëtimin e mjeteve dhe të mirave materiale të shkaktuara nga zjarri, nga fatkeqësitë natyrore, siç janë: vërshimet, përmbytjet nga uji, shembja e dheut etj., për intervenime gjatë aksidenteve në trafik e fatkeqësi të tjera. Ky shërbim në vitin raportues ka evidencuar gjithsej 615 dalje, nga të cilat 426 janë për zjarre, 95 për shërbime, 27 për aksidente rrugore, 24 për vërshime, 25 dalje për thirrje të rrejshme dhe 18 të tjera.

Duke parë numrin e daljeve të personelit dhe të automjeteve zjarrfikëse që janë përdorur gjatë intervenimit, veçojmë se shpenzimet për këtë njësi janë në rritje e sipër, prandaj duhet kushtuar një kujdes të veçantë që të shtohet buxheti për këtë njësi, në mënyrë që efikasiteti i intervenimeve të jetë në nivelin e dëshiruar. Duhet kushtuar kujdes të posaçëm aftësimit dhe profesionalizmit të pjesëtarëve të BZP-së, si dhe shtimin e numrit të personelit dhe ndarjen e mjeteve financiare për pajisjen e BSP-së me automjete për zjarrfikje dhe pajisje tjera të nevojshme.

Shkaqet e zjarreve janë: pakujdesia, të metat ndërtimore, rryma elektrike, kalljet e qëllimta, vetkalljet, kalljet e shkaktuara nga fëmijët etj.

Viti 2005	REALIZIMI								
Janar	Numri i përgjithshëm	Numri i zjarreve	Shërbime	Aksidente rrugore	Vërshime	Thirr.të rrejshme	Të vdekur	Të lënduar	Të tjera
Dhjetor	615	426	95	27	24	25	10	42	18

Viti 2005	STRUKTURA E ZJARREVE DHE PËRQINDJA					
Janar-dhjetor	Objektet ndërtimore	Zjarre sipërfaqe hapura	në të	Në automjete	Pajisje elektrike	Të tjera
	223-52,3%	116-25.8%		43 -11%	42 - 10%	2-0,5%

#### PASQYRA E NUMRIT TË ZJARREVE NË OBJEKTE NDËRTIMI DHE NË SIPËRFAQE TË HAPURA PËR PERIU DHËN JANAR – DHJETOR 2005, SIPAS MUAJVE

Nr.	MUAJI	NUMRI INTERVENIMEVE	PËRQINDJA	VËREJTJE
1.	Janar	31	7.27%	

2.	<b>Shkurt</b>	26	6.1%	
3.	Mars	32	7.21%	
4.	Prill	42	9.85%	
5.	Maj	31	7.27%	
6.	Qershor	32	7.51%	
7.	Korrik	43	10%	
8.	Gusht	52	12.2%	
9.	Shtator	34	7.98%	
10.	Tetor	38	8.92%	
11.	Nëntor	37	8.70%	
12.	Dhjetor	23	5.4%	

Për vitin raportues 2005 Drejtorati i DSC ka planifikuar që buxheti vjetor të jetë 500.000 Euro, ndërsa nga Kuvendi i Komunës janë miratuar 477.000 Euro.

Prej buxhetit të miratuar, për projekte të ndryshme janë shpenzuar 231.443,43 euro ose 48.5%, ndërsa të pashpenzuara kanë mbetur 245.555,57 euro ose 51.5%.

Për shpenzime kapitale janë realizuar .....172.457.20 €

- 1). Furnizimi i QIAK-së me radiolidhje .....9765.80 euro për MF sistem ,
- 2). Mirëmbajtja e repetitorit në Golesh .....5000 €
- 3). Pajisja me radiolidhje DMCE dhe BL..... 37.958.05 €
- 4). Pajisja e Drejtoratit me automjet komandues Xhip "NISAN" .....18.750 €
- 5). Blerja e automjetit komandues për punktin 2 – Llaple- Sellë, Lada "NIVA" .....9315 €
- 6). Pajisja e BZP-së me mjete materiale teknike .....9965.80 €
- 7). Pajisja e zjarrfikësve me robe adekuate, 135 palë ..... 17.951.85 €
- 8). Blerja e 100 pjesëve zorrë përcjellëse të ujit për shuarjen e zjarrit .....5.681,00 €
- 9). Blerja e tre kontejnerëve .....5.550 €
- 10) Blerja e mjeteve speciale për zjarrfikës, helmata dhe çizme.....28.714.70 €
- 11) Blerja e 135 kompleteve të rrobave për zjarrfikës, për sezonin dimëror .....23.805 €

Për shërbime e mallra janë shpenzuar 16.459.83 €, ndërsa për derivate 29050.51 € dhe mjete kesh 13.476.89 €.

**VËREJTJE:** Edhe pse është shpallur tenderi për servisimin e platformës së shkallëve hidraulike ( i cili do të kushtonte 35.000 euro), dy autocisterne për BZP-në ( me vlerë prej 70.000 €), si dhe një automjet sulmues, me vlerë prej 45.000,00 €, nuk janë realizuar për shkak të mungesës së ofertuesve adekuat.

Mund të konkludojmë se detyrat dhe aktivitetet e planifikuara në këtë dejtorat janë realizuar me sukses të plotë. Për vitin 2006 mbetet të përfundohen projektet kapitale të planifikuara për plotësim të BZP-së.